

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Rregullorja (BE) 2022/2065 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 19 tetor 2022, mbi Tregun e Vetëm për Shërbimet Digjitale dhe për ndryshimin e Direktivës 2000/31/KE (Akti për Shërbimet Digjitale - Digital Services Act), numri CELEX 32022R2065, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 277/1, datë 27.10.2022.		Legjislacioni Shqiptar 1. Draft ligj “Për shërbimet digjitale në Republikën e Shqipërisë” 2. Draft ligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128/2009 “Për tregtine elektronike” të ndryshuar F – përputhshmëri e plotë P – përputhshmëri e pjesshme N – mospërputhshmëri (ose mungesë përputhshmërie)				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Tekst	Referenca	Neni	Përmbajtja	Përputhshmëria	Shënime
<i>Kjo kolonë tregon vetëm numrin e nenit të instrumentit të acquis-së së BE-së ose numrin e paragrafit apo nënparagrafit përkatës.</i>	<i>Kjo kolonë përmban tekstin e nenit që korrespondon me numrin e treguar në kolonën e parë. Nëse është e nevojshme, çdo nen mund të ndahet në paragrafë ose nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.</i>	<i>Një dispozitë është ga më shumë se një akti, kështu që kjo kolonë shënohet numri i referencës, sipas renditjes së rrethit të tabelës (*).</i>	<i>Kjo kolonë tregon numrin e nenit të aktit juridik kombëtar.</i>	<i>Kjo kolonë tregon tekstin e nenit, ose të pjesëve të nenit, të cilit i korrespondon numri i treguar në kolonën e katërt dhe që ka përfaqësuar kërkesat e nenit përkatës të acquis-së së BE-së të paraqitura në kolonën e dytë.</i>	<i>Kjo kolonë tregon shkallën e përafërimit për secilin nen të veçantë.</i>	<i>Kjo kolonë jep informacion mbi shkallën e përafërimit. Kur përafërimi nuk është i plotë, paraqiten arsyet përkatëse dhe afatet brenda të cilave do të realizohet përafërimi i plotë.</i>
1.1	Neni 1 Qëllimi Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të kontribuojë në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm për shërbimet ndërmjetësuese duke përcaktuar rregulla të harmonizuara për një mjedis online të sigurt, të parashikueshëm dhe të besueshëm që lehtëson inovacionin dhe në të cilin të drejtat themelore të sanksionuara në Kartë, përfshirë parimin e mbrojtjes së konsumatorit, mbrohen në mënyrë efektive.	1	1.1	Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i këtij ligji është të kontribuojë në mirëfunksionimin e shërbimeve ndërmjetëse në Republikën e Shqipërisë, duke vendosur rregulla të harmonizuara për një mjedis online të sigurt, të parashikueshëm dhe të besueshëm, që promovon inovacionin dhe mbron të drejtat themelore të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përfshirë parimin e mbrojtjes së konsumatorit.	F	

1.2	Kjo Rregullore përcakton rregulla të harmonizuara mbi ofrimin e shërbimeve ndërmjetësuese në tregun e brendshëm. Në veçanti, ajo përcakton:	1	1.2	2. Ky ligj përcakton rregulla për ofrimin e shërbimeve ndërmjetëse në Republikën e Shqipërisë, të harmonizuara me praktikën e Bashkimit Evropian dhe krijon në veçanti:	F	
1.2.a	(a) një kuadër për përjashtimin me kusht nga përgjegjësia e ofruesve të shërbimeve ndërmjetësuese;	1	1.2.a	a)një kuadër përjashtimi të kushtëzuar nga përgjegjësia, për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse;	F	
1.2.b	(b) rregulla mbi detyrimet specifike të kujdesit të duhur, të përshtatura për kategori të caktuara specifike të ofruesve të shërbimeve ndërmjetësuese;	1	1.2.b	b)rregulla për detyrime specifike për kujdesin e duhur, të përshtatura sipas kategorive të ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse;	F	
1.2.c	(c) rregullat mbi zbatimin dhe garantimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje, duke përfshirë edhe bashkëpunimin dhe koordinimin midis autoriteteve kompetente.	1	1.2.c	c) rregulla për zbatimin dhe garantimin e zbatimit të këtij ligji, përfshirë ato në lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, të harmonizuara me praktikën e Bashkimit Evropian.	F	
2.1	Neni 2 Fusha e zbatimit Kjo Rregullore zbatohet për shërbimet ndërmjetësuese të ofruara për përfituesit e shërbimit që kanë vendin e tyre të themelimit ose ndodhen në Bashkim, pavarësisht se ku ofruesit e këtyre shërbimeve ndërmjetësuese kanë vendin e tyre të themelimit.	1	2.1	Neni 2 Fusha e zbatimit 1.Ky ligj zbatohet për shërbimet ndërmjetëse që ofrohen për marrësit e shërbimeve që janë themeluar ose ndodhen në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht se ku është themeluar ofruesi i këtyre shërbimeve.	F	
2.2	Kjo Rregullore nuk zbatohet për asnjë shërbim që nuk është një shërbim ndërmjetës ose për asnjë kërkesë të vendosur në lidhje me një shërbim të tillë, pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nëpërmjet përdorimit të një shërbimi ndërmjetës.	1	2.2	2.Ky ligj nuk zbatohet për çdo shërbim tjetër që nuk është shërbim ndërmjetësimi, ose për ndonjë kërkesë të lidhur me një shërbim të tillë, pavarësisht nëse shërbimi ofrohet përmes përdorimit të një shërbimi ndërmjetësimi.	F	
2.3	Kjo Rregullore nuk ndikon në zbatimin e Direktivës 2000/31/KE.	1	2.3	3.Ky ligj nuk çënon zbatimin e ligjit nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”, të ndryshuar.	F	
2.4	Kjo Rregullore nuk çënon rregullat e përcaktuara nga akte të tjera ligjore të Bashkimit që rregullojnë aspekte të tjera të ofrimit të shërbimeve ndërmjetësuese në tregun e brendshëm ose që specifikojnë dhe plotësojnë këtë Rregullore, në veçanti, sa vijon:	1	2.4	4.Ky ligj nuk çënon rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, që rregullon aspekte të tjera të ofrimit të shërbimeve ndërmjetëse, ose që specifikon dhe plotëson rregullimet sipas këtij ligji, veçanërisht në fushat si më poshtë:	F	
2.4.a	(a) Direktiva 2010/13/EU;	1	2.4.a	a)shërbimet e medias audiovizive, sipas ligjit nr. 97/2013 të ndryshuar;	F	

2.4.b	(b) Ligji i Unionit mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të;	1	2.4.b	b) e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, sipas ligjit nr. 35/2016 të ndryshuar;	F	
2.4.c	(c) Rregullorja (EU) 2021/784;	1	2.4.c	c) parandalimin e përhapjes së përmbajtjes terroriste në internet;	F	
2.4.d	(d) Rregullorja (EU) 2019/1148;	1	2.4.ç	ç) tregtimin dhe përdorimin e prekursorëve të eksplozivëve;	F	
2.4.e	(e) Rregullorja (EU) 2019/1150;	1	2.4.d	d) promovimin e transparencës dhe konkurrencës së ndershme për përdoruesit biznes të shërbimeve të ndërmjetësimit online;	F	
2.4.f	(f) Ligji i Unionit për mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produkteve, duke përfshirë Rregulloret (BE) 2017/2394 dhe (BE) 2019/1020 dhe Direktivat 2001/95/KE dhe 2013/11/BE;	1	2.4.dh	dh) mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produktit;	F	
2.4.g	(g) Ligji i Unionit për mbrojtjen e të dhënave personale, në veçanti Rregullorja (BE) 2016/679 dhe Direktiva 2002/58/KE;	1	2.4.e	e) mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit nr. 124/2024 dhe dhe Kreut XIX, të ligjit nr. 54/2024 për komunikimet elektronike;	F	
2.4.h	(h) Ligji i Unionit në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile, në veçanti Rregullorja (BE) nr. 1215/2012 ose çdo akt ligjor i Unionit që përcakton rregullat mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktuale dhe jokontraktuale;	1	2.4.ë	ë) bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet civile, sipas Kodit të Procedurës Civile të Shqipërisë;	F	
2.4.i	(i) Ligji i Unionit në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, në veçanti një Rregullore mbi Urdhrat Evropianë të Paraqitjes dhe Ruajtjes për provat elektronike në çështjet penale;	1	2.4.f	f) bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale.	F	
2.4.j	(j) një Direktivë që përcakton rregulla të harmonizuara mbi emërimin e përfaqësuesve ligjorë me qëllim mbledhjen e provave në procedurat penale.				E paaplikueshme	Nuk ka nevojë të përafrohet për sa kohë që Shqipëria nuk ka rregulla të tilla ose nuk vendos rregulla të tilla.
3	Neni 3 Përkufizime Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme	1	3	Neni 3 Përkufizime Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:	F	
3.a	(a) "shërbim i shoqërisë së informacionit" do të thotë një "shërbim" siç përcaktohet në nenin 1(1), pika (b), të Direktivës (BE) 2015/1535;	1	3.20	20. "Shërbim i shoqërisë së informacionit" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në pikën 70, të nenit 4, të Ligjit Nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".	F	
3.b	(b) "marrës i shërbimit" do të thotë çdo person fizik ose juridik që përdor një shërbim	1	3.10	10. "Marrës i shërbimit", është çdo person fizik ose juridik që përdor një shërbim	F	

	ndërmjetës, në veçanti për qëllime të kërkimit të informacionit ose bërjes së tij të arritshëm;			ndërmjetës, veçanërisht me qëllimin e kërkimit të informacionit ose të bërjes së tij të aksesueshëm.		
3.c	(c) "konsumator" do të thotë çdo person fizik që vepron për qëllime që janë jashtë tregtisë, biznesit, zanatit ose profesionit të tij ose të saj;	1	3.3	3. "Konsumator" është çdo person fizik që vepron për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin, zanatin ose ushtrimin e profesionit të tij.	F	
3.d	(d) "të ofrosh shërbime në Bashkim" do të thotë t'u mundësosh personave fizikë ose juridikë në një ose më shumë Shtete Anëtare të përdorin shërbimet e një ofruesi të shërbimeve ndërmjetësuese që ka një lidhje të konsiderueshme me Bashkimin;	1	3.23	23. "Të ofrojë shërbime në territorin kombëtar" nënkupton mundësimin që personat fizik ose juridikë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë të përdorin shërbimet e një ofruesi të shërbimeve ndërmjetëse që ka një lidhje të konsiderueshme/thelbësore me territorin e Republikës së Shqipërisë;	F	
3.e	(e) "lidhje thelbësore me Bashkimin" do të thotë një lidhje e një ofruesi të shërbimeve ndërmjetësuese me Bashkimin që rezulton ose nga vendosja e tij në Bashkim ose nga kritere specifike faktike, të tilla si: - një numër i konsiderueshëm marrësish të shërbimit në një ose më shumë Shtete Anëtare në raport me popullsinë e tij ose të tyre; ose - synimi i aktiviteteve drejt një ose më shumë Shteteve Anëtare;	1	3.2	2. "I konsiderueshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë" nënkupton lidhjen ndërmjet një ofruesi të shërbimeve ndërmjetëse dhe territorit të Republikës së Shqipërisë, që rrjedh nga fakti se ofruesi është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, ose nga kritere faktike specifike, si: a) ofruesi ka një numër të konsiderueshëm të marrësve të shërbimit në Republikën e Shqipërisë në lidhje me popullsinë ose, b) veprimtaria e tij është e synuar për Republikën e Shqipërisë.	F	
3.f	(f) "tregtar" do të thotë çdo person fizik ose çdo person juridik, pavarësisht nëse është në pronësi private apo publike, i cili vepron, duke përfshirë edhe nëpërmjet çdo personi që vepron në emrin e tij ose të saj ose në emër të tij ose të saj, për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij ose të saj;	1	3.24	24. "Tregtar" do të thotë çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nëse është në pronësi private apo publike, i cili vepron, vetë apo nëpërmjet çdo personi tjetër që vepron në emrin ose në llogari të tij, për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij;	F	
3.g	(g) "Shërbim ndërmjetës" do të thotë një nga shërbimet e mëposhtme të shoqërisë së informacionit:	1	3.21	21. "Shërbim ndërmjetësimi" nënkupton një nga shërbimet e shoqërisë së informacionit si më poshtë:	F	
3.g.i	(i) një shërbim 'transmetim i thjeshtë', që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ose ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi;	1	3.21.a	a) "Transmetimi i thjeshtë" 'mere conduit', është shërbimi i ofruar për transmetimin përmes një rrjeti komunikimi, të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ose për sigurimin e aksesit në një rrjet komunikimi;	F	

3.g.ii	(ii) një shërbim ‘caching’, që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, që përfshin ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të atij informacioni, të kryer me qëllimin e vetëm për ta bërë më efikas transmetimin e mëtejshëm të informacionit të marrës të tjerë me kërkesën e tyre;	1	3.21.b	b) ‘Caching’ është shërbimi që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, që përfshin ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të informacionit të transmetuar, me qëllim transmetimin në mënyrë më të efektshme të informacionit dhe për aksesimin më të shpejtë të informacionit në rast ripërdorimi nga përdoruesit me kërkesë të tyre.	F	
3.g.iii	(iii) një shërbim ‘hostimi’, që konsiston në ruajtjen e informacionit të ofruar nga dhe me kërkesë të një marrësi të shërbimit;	1	3.21.c	c) ‘Hosting’ është shërbimi që konsiston në ruajtjen e informacionit të dhënë nga një marrës i shërbimit me kërkesën e tij ose të saj;	F	
3.h	(h) "përmbajtje e paligjshme" do të thotë çdo informacion që, në vetvete ose në lidhje me një aktivitet, duke përfshirë shitjen e produkteve ose ofrimin e shërbimeve, nuk është në përputhje me ligjin e Bashkimit ose me ligjin e çdo Shteti Anëtar që është në përputhje me ligjin e Bashkimit, pavarësisht nga lënda ose natyra e saktë e atij ligji;	1	3.15	15. “Përmbajtje e paligjshme” nënkupton çdo informacion që, vetë ose i lidhur me një veprimtari, duke përfshirë shitjen e produkteve ose ofrimin e shërbimeve, nuk është në përputhje me ligjin, pavarësisht nga objekti konkret apo natyra e atij ligji;	F	
3.i	(i) "platformë online" do të thotë një shërbim pritës që, me kërkesë të një marrësi të shërbimit, ruan dhe shpërndan informacion për publikun, përveç nëse ky aktivitet është një tipar i vogël dhe thjesht ndihmës i një shërbimi tjetër ose një funksionalitet i vogël i shërbimit kryesor dhe, për arsye objektive dhe teknike, nuk mund të përdoret pa atë shërbim tjetër, dhe integrimi i veçorisë ose funksionalitetit në shërbimin tjetër nuk është një mjet për të anashkaluar zbatueshmërinë e kësaj Rregulloreje;	1	3.16	16. “Platformë online” nënkupton një shërbim ‘hosting’ që, me kërkesë të një marrësi të shërbimit, ruan dhe shpërndan informacion për publikun, përveç rastit kur kjo veprimtari është një veçori e vogël dhe thjesht ndihmëse e një shërbimi tjetër ose një funksion i vogël i shërbimit kryesor dhe, për arsye teknike dhe objektive, nuk mund të përdoret pa këtë shërbim tjetër, dhe integrimi i veçorisë ose funksionit në atë shërbim tjetër nuk është një mjet për të anashkaluar zbatimin e këtij ligji;	F	
3.j	(j) "motor kërkimi online" do të thotë një shërbim ndërmjetës që u lejon përdoruesve të fusin pyetje me qëllim kryerjen e kërkimeve, në parim, në të gjitha faqet e internetit ose në të gjitha faqet e internetit në një gjuhë të caktuar, në bazë të një pyetjeje mbi çdo temë në formën e një fjale kyçe, kërkese zanore, fraze ose ndonjë inputi tjetër, dhe kthen rezultate në çdo format në të cilin mund të gjendet informacioni në lidhje me përmbajtjen e kërkuar;	1	3.12	12. “Motor kërkimi në internet” nënkupton një shërbim ndërmjetës që u lejon përdoruesve të vendosin kërkesa për të kërkuar, në parim, në të gjitha faqet e internetit ose faqet e internetit në një gjuhë të caktuar në bazë të një kërkese për çdo subjekt në formën e një fjale kyçe, komande zanore, shprehjeje ose e dhënë tjetër dhe që ofron rezultate në çdo format në të cilin mund të gjenden informacione që lidhen me përmbajtjen e kërkuar	F	

3.k	(k) "shpërndarje për publikun" do të thotë vënia në dispozicion e informacionit, me kërkesë të marrësit të shërbimit që e ka ofruar informacionin, për një numër potencialisht të pakufizuar palësh të treta;	1	3.22	22. "Shpërndarja për publikun", nënkupton vënien e informacionit në dispozicion të një numri potencialisht të pakufizuar palësh të treta, me kërkesë të marrësit të shërbimit që ka dhënë informacionin.	F	
3.l	(l) "kontratë në distancë" do të thotë "kontratë në distancë" siç përcaktohet në nenin 2, pika (7), të Direktivës 2011/83/BE;	1	3.4	4. "Kontratë në distancë" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në pikën 22, të nenit 3, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", të ndryshuar.	F	
3.m	(m) "ndërfaqe online" do të thotë çdo softuer, duke përfshirë një faqe interneti ose një pjesë të saj, dhe aplikacione, duke përfshirë aplikacionet mobile;	1	3.13	13. "Ndërfaqe online" nënkupton çdo program kompjuterik 'software', përfshirë një faqe interneti ose pjesë të saj, dhe aplikacione, përfshirë aplikacionet për celularë.	F	
3.n	(n) "Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i institucionit" do të thotë Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i Shtetit Anëtar ku ndodhet institucioni kryesor i një ofruesi të një shërbimi ndërmjetës ose ku banon ose është i themeluar përfaqësuesi i tij ligjor;	1	3.6	6. "Koordinatori i Shërbimeve Digjitale" është organi rregullator i përcaktuar si Koordinatori i Shërbimeve Digjitale në përputhje me nenin 49 dhe sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji.	F	
3.o	(o) "Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i destinacionit" do të thotë Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i një Shteti Anëtar ku ofrohet shërbimi ndërmjetës;	1			E paaplikueshme	Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i destinacionit, lidhet me zbatimin e procedurave të brendshme në BE;
3.p	(p) "marrës aktiv i një platforme online" do të thotë një marrës i shërbimit që është angazhuar me një platformë online duke kërkuar që platforma online të strehojë informacion ose duke u ekspozuar ndaj informacionit të strehuar nga platforma online dhe të shpërndarë përmes ndërfaqes së saj online;	1	3.8	8. "Marrës aktiv i një platforme online" nënkupton një marrës shërbimi që ka ndërvepruar me një platformë online ose duke kërkuar hostimin e informacionit në platformën online, ose duke u ekspozuar ndaj informacionit të hostuar në platformën online dhe është shpërndarë përmes ndërfaqes së saj online.	F	
3.q	(q) "marrës aktiv i një motori kërkimi online" do të thotë një marrës i shërbimit që ka paraqitur një kërkesë në një motor kërkimi online dhe është ekspozuar ndaj informacionit të indeksuar dhe të paraqitur në ndërfaqen e tij online;	1	3.9	9. "Marrës aktiv i një motori kërkimi online" nënkupton një marrës shërbimi që ka futur një pyetje në një motor kërkimi online dhe i është ekspozuar informacionit të indeksuar dhe të paraqitur përmes ndërfaqes së tij online;	F	
3.r	(r) "reklamë" do të thotë informacion i hartuar për të promovuar mesazhin e një personi juridik ose fizik, pavarësisht nëse për të arritur qëllime tregtare apo jo-tregtare, dhe i paraqitur nga një platformë online në ndërfaqen e saj online	1	3.18	18. "Reklamë" nënkupton informacionin e projektuar për promovimin e mesazhit të një personi fizik ose juridik, i paraqitur nga një platformë online në ndërfaqen e saj online kundrejt shpërblimit, për qëllime tregtare ose jo, me qëllimin specifik të promovimit të atij	F	

	kundrejt një shpërblimi specifik për promovimin e atij informacioni;			informacioni.		
3.s	(s) "sistem rekomandimi" do të thotë një sistem plotësisht ose pjesërisht i automatizuar i përdorur nga një platformë online për të sugjeruar në ndërfaqen e saj online informacione specifike për marrësit e shërbimit ose për t'i dhënë përparësi këtij informacioni, duke përfshirë edhe si rezultat i një kërkimi të iniciuar nga marrësi i shërbimit ose duke përcaktuar ndryshe rendin ose rëndësinë relative të informacionit të shfaqur;	1	3.19	19. “Sistem rekomandues” nënkupton një sistem plotësisht ose pjesërisht të automatizuar, i përdorur nga një platformë online për t’u sugjeruar marrësve të shërbimit në ndërfaqen e saj online, informacion specifik ose për t’i dhënë përparësi atij informacioni, përfshirë një rezultat të kërkimit të inicuar nga marrësi i shërbimit ose ndryshe duke përcaktuar rendin ose rëndësinë relative të informacionit të shfaqur.	F	
3.t	(t) "moderim i përmbajtjes" do të thotë aktivitetet, të automatizuara apo jo, të ndërmarra nga ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, që synojnë, në veçanti, zbulimin, identifikimin dhe adresimin e përmbajtjes ose informacionit të paligjshëm të papajtueshëm me termat dhe kushtet e tyre, të ofruara nga marrësit e shërbimit, duke përfshirë masat e marra që ndikojnë në disponueshmërinë, dukshmërinë dhe aksesin e asaj përmbajtjeje të paligjshme ose atij informacioni, siç është ulja në detyrë, çmonetizimi, pamundësimi i aksesit ose heqja e tij, ose që ndikojnë në aftësinë e marrësit të shërbimit për të ofruar atë informacion, siç është mbyllja ose pezullimi i llogarisë së një marrësi;	1	3.11	11.“Moderimi i përmbajtjes” nënkupton veprimtari, të automatizuara ose jo, që ndërmerren nga ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, në veçanti me qëllimin e zbulimit, identifikimit dhe trajtimit të përmbajtjes së paligjshme ose informacionit të papajtueshëm me kushtet dhe termat e tyre, të ofruar nga marrësit e shërbimit, duke përfshirë masat e marra që ndikojnë në disponueshmërinë, shikueshmërinë dhe aksesimin e kësaj përmbajtje apo informacioni të paligjshëm të tilla si kufizimi, çmonetizimi, çaktivizimi i aksesit ose heqja e asaj përmbajtjeje apo atij informacioni, ose në marrjen e masave që ndikojnë në aftësinë e përdoruesve të shërbimit për të ofruar atë informacion, siç është mbyllja ose pezullimi i llogarisë së përdoruesit.	F	
3.u	(u) "kushte dhe afate" do të thotë të gjitha klauzolat, pavarësisht nga emri ose forma e tyre, të cilat rregullojnë marrëdhënien kontraktuale midis ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse dhe përfituesve të shërbimit;	1	3.7	7. “Kushtet dhe termat” nënkuptojnë të gjithë termat, pavarësisht emërimit ose formës së tyre, që rregullojnë marrëdhënien kontraktore ndërmjet ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse dhe marrësve të shërbimit.	F	
3.v	(v) "persona me aftësi të kufizuara" do të thotë "persona me aftësi të kufizuara" siç përmendet në nenin 3, pika (1), të Direktivës (BE) 2019/882 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (38);	1	3.14	14.“Personat me aftësi të kufizuara” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në Ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.	F	
3.w	(w) "komunikim tregtar" do të thotë "komunikim tregtar" siç përcaktohet në nenin 2, pika (f), të Direktivës 2000/31/KE;	1	3.5	3.“Komunikim tregtar” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 3, të Ligjit Nr. 10128/2009 “Për tregtinë elektronike” të ndryshuar.	F	
3.x	(x) "xhiro" do të thotë shuma e përfituar nga një ndërmarrje sipas kuptimit të Nenit 5(1) të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 (39);	1	3.17	17.“Qarkullim” nënkupton totalin e të ardhurave të realizuara nga një ndërmarrje mbi bazë vjetore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.	F	
4.1	Neni 4	1	4.1	Neni 4	F	

	‘Mere Conduit’			Transmetimi i thjeshtë ‘Mere Conduit’		
	Kur ofrohet një shërbim i shoqërisë së informacionit që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ose në ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi, ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar ose të aksesuar, me kusht që ofruesi:			1.Kur ofrimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit, ose në ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi, ofruesi i shërbimit nuk mban përgjegjësi për informacionin e transmetuar ose të aksesuar, nëse ofruesi:		
4.1.a	(a) nuk e fillon transmetimin;	1	4.1.a	a) nuk inicion transmetimin;	F	
4.1.b	(b) nuk zgjedh marrësin e transmetimit; dhe	1	4.1.b	b) nuk zgjedh marrësin e transmetimit; dhe	F	
4.1.c	(c) nuk zgjedh ose modifikon informacionin e përfshirë në transmetim.	1	4.1.c	c) nuk zgjedh ose modifikon përmbajtjen e informacionit që transmetohet.	F	
4.2	Aktet e transmetimit dhe të ofrimit të aksesit të përmendura në paragrafin 1 përfshijnë ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të informacionit të transmetuar për aq sa kjo ndodh vetëm për qëllimin e kryerjes së transmetimit në rrjetin e komunikimit, dhe me kusht që informacioni të mos ruhet për ndonjë periudhë më të gjatë se sa është e nevojshme në mënyrë të arsyeshme për transmetimin.	1	4.2	2.Veprimet e transmetimit dhe të ofrimit të aksesit, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshijnë ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të informacionit të transmetuar, për aq kohë sa ruajtja shërben ekskluzivisht për përcjelljen e transmetimit në rrjetin e komunikimit dhe me kusht që kohëzgjatja e ruajtjes të mos e tejkalojë kohën e nevojshme të arsyeshme për të kryer transmetimin.	F	
4.3	Ky nen nuk ndikon në mundësinë e një autoriteti gjyqësor ose administrativ, në përputhje me sistemin ligjor të një shteti anëtar, për t'i kërkuar ofruesit të shërbimit të ndërpresë ose parandalojë një shkelje.	1	4.3	3.Ky nen nuk cënon mundësinë që gjykata ose një autoritet kompetent, t'i kërkojë ofruesit të shërbimit ndërprerjen, ose të parandalojë një shkelje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	F	
5.1	Neni 5 “Caching” Kur ofrohet një shërbim i shoqërisë së informacionit që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të atij informacioni, të kryer me qëllimin e vetëm për ta bërë më efikas ose më të sigurt transmetimin e mëtejshëm të informacionit të marrës të tjerë të shërbimit me kërkesën e tyre, me kusht që ofruesi:	1	5.1	Neni 5 Ruajtja e përkohshme e informacionit “Caching” 1.Gjatë transmetimit të informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit në rrjetin e komunikimit, ofruesi i shërbimit që ofron transmetimin nuk është përgjegjës për ruajtjen e përkohshme, të ndërmjetme dhe automatike, të atij informacioni, për sa kohë që ruajtja shërben vetëm për ta bërë transmetimin e mëtejshëm të informacionit për marrësit e tjerë të shërbimit më efikas, ose më të sigurtë, me kërkesën e tyre, nëse ofruesi:	F	
5.1.a	(a) nuk e modifikon informacionin;	1	5.1.a	a)nuk modifikon informacionin;	F	

5.1.b	(b) përmbush kushtet për aksesin në informacion;	1	5.1.b	b) përmbush kushtet e aksesit në informacion;	F	
5.1.c	(c) përputhet me rregullat në lidhje me përditësimin e informacionit, të specifikuara në një mënyrë të njohur gjerësisht dhe të përdorur nga industria;	1	5.1.c	c) respekton rregullat për përditësimin e informacionit, të përcaktuara në një mënyrë që njihet dhe përdoret gjerësisht në industri;	F	
5.1.d	(d) nuk ndërhyr në përdorimin e ligjshëm të teknologjisë, të njohur gjerësisht dhe të përdorur nga industria, për të marrë të dhëna mbi përdorimin e informacionit; dhe	1	5.1.ç	ç) parandalon përdorimin e paligjshëm të teknologjisë, të njohur dhe të përdorur gjerësisht në industri, me qëllim marrjen e të dhënave mbi përdorimin e informacionit; dhe	F	
5.1.e	(e) vepron me shpejtësi për të hequr ose për të çaktivizuar aksesin në informacionin që ka ruajtur, sapo merr dijeni për faktin se informacioni në burimin fillestar të transmetimit është hequr nga rrjeti, ose aksesin në të është çaktivizuar, ose se një autoritet gjyqësor ose administrativ ka urdhëruar një heqje ose çaktivizim të tillë.	1	5.1.d	d) vepron me shpejtësi për të hequr, ose për të çaktivizuar aksesin në informacionin që ka ruajtur sapo merr dijeni se informacioni në burimin fillestar të transmetimit është hequr nga rrjeti, aksesin në të është çaktivizuar, ose gjykata, apo një autoritet kompetent ka urdhëruar heqjen, ose çaktivizimin e aksesit në atë informacion.	F	
5.2	Ky nen nuk ndikon në mundësinë e një autoriteti gjyqësor ose administrativ, në përputhje me sistemin ligjor të një shteti anëtar, për t'i kërkuar ofruesit të shërbimit të ndërpresë ose parandalojë një shkelje.	1	5.2	2.Ky nen nuk cënon mundësinë që gjykata ose një autoritet kompetent, në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm, të kërkojë që ofruesi i shërbimit të ndërpresë, ose të parandalojë një shkelje.	F	
6.1	Neni 6 “Hosting” Kur ofrohet një shërbim i shoqërisë së informacionit që konsiston në ruajtjen e informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesë të një marrësi të shërbimit, me kusht që ofruesi:	1	6.1	Neni 6 Shërbimi i ruajtjes të informacionit “Hosting” 1. Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit, konsiston në ruajtjen e informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesë të marrësit të shërbimit, nëse ofruesi:	F	
6.1.a	(a) nuk ka njohuri reale për aktivitetin ose përmbajtjen e paligjshme dhe, në lidhje me kërkesat për dëmshpërblim, nuk është në dijeni të fakteve ose rrethanave nga të cilat aktiviteti ose përmbajtja e paligjshme është e dukshme; ose	1	6.1.a	a)nuk ka ose nuk mund të ketë dijeni për veprimtarinë e paligjshme ose përmbajtjen e paligjshme dhe sa u përket pretendimeve për dëmshpërblim, nuk është në dijeni të fakteve ose rrethanave nga të cilat rezultojnë veprimtaria, ose përmbajtja e paligjshme; ose	F	
6.1.b	(b) me marrjen e një dijenie ose ndërgjegjësimi të tillë, vepron me shpejtësi për të hequr ose për të çaktivizuar aksesin në përmbajtjen e paligjshme.	1	6.1.b	b)me marrjen dijeni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në përmbajtjen e paligjshme.	F	
6.2	Paragrafi 1 nuk zbatohet kur marrësi i shërbimit vepron nën autoritetin ose kontrollin e ofruesit.	1	6.2	2.Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet kur marrësi i shërbimit vepron në emër ose në kontrollin e ofruesit të shërbimit.	F	
6.3	Paragrafi 1 nuk zbatohet në lidhje me përgjegjësinë sipas ligjit për mbrojtjen e	1	6.3	3.Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet në lidhje me përgjegjësitë sipas ligjit për mbrojtjen e	F	

	konsumatorit të platformave online që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarët, kur një platformë e tillë online paraqet informacionin specifik ose mundëson transaksionin specifik në fjalë në një mënyrë që do ta bënte një konsumator mesatar të besonte se informacioni, ose produkti ose shërbimi që është objekt i transaksionit, ofrohet ose nga vetë platforma online ose nga një marrës i shërbimit i cili vepron nën autoritetin ose kontrollin e saj.			konsumatorit, për platformat online që lejojnë konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarët, kur platforma online paraqet informacionin e një produkti specifik, ose në ndonjë mënyrë tjetër lehtëson transaksionin specifik në fjalë, në mënyrë të tillë që e bën një konsumator mesatar të besojë se informacioni, produkti ose shërbimi që është objekt i transaksionit, ofrohet nga vetë platforma online, ose nga një marrës i shërbimit që vepron në emër ose nën kontrollin e saj.		
6.4	Ky nen nuk ndikon në mundësinë e një autoriteti gjyqësor ose administrativ, në përputhje me sistemin ligjor të një shteti anëtar, për t'i kërkuar ofruesit të shërbimit të ndërpresë ose parandalojë një shkelje.	1	6.4	4.Ky nen nuk cënon mundësinë që gjykata ose një autoritet kompetent, në përputhje me ligjin kombëtar të zbatueshëm, t'i kërkojë ofruesit të shërbimit të ndërpresë, ose të parandalojë një shkelje.	F	
7	Neni 7 Hetimet vullnetare dhe përputhshmëria ligjore Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse nuk do të konsiderohen të papërshtatshëm për përjashtimet nga përgjegjësia e përmendura në nenet 4, 5 dhe 6 vetëm sepse ata, me mirëbesim dhe në mënyrë të kujdesshme, kryejnë hetime vullnetare me iniciativën e tyre ose marrin masa të tjera që synojnë zbulimin, identifikimin dhe heqjen, ose pamundësimin e aksesit në përmbajtje të paligjshme, ose marrin masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat e ligjit të Bashkimit dhe ligjit kombëtar në përputhje me ligjin e Bashkimit, duke përfshirë kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.	1	7	Neni 7 Hetimet vullnetare me nismën e ofruesit dhe përputhshmëria ligjore Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që, në mirëbesim dhe në mënyrë të kujdesshme, kryejnë hetime vullnetare me nismën e tyre, në lidhje me përmbajtjet e paligjshme, ose marrin masa të tjera që synojnë zbulimin, identifikimin dhe heqjen, ose çaktivizimin e aksesit në këto përmbajtje, apo që marrin masat e nevojshme për të respektuar kërkesat sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, nuk konsiderohen të papërshtatshëm për përjashtimet nga përgjegjësia sipas përcaktimeve në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji.	F	
8	Neni 8 Asnjë monitorim i përgjithshëm ose detyrime aktive për gjetjen e fakteve Asnjë detyrim i përgjithshëm për të monitoruar informacionin që ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse transmetojnë ose ruajnë, as për të kërkuar në mënyrë aktive fakte ose rrethana që tregojnë aktivitet të paligjshëm, nuk do t'u imponohet këtyre ofruesve.	1	8	Neni 8 Mungesa edetyrimit të përgjithshëm për monitorim Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse nuk kanë asnjë detyrim të përgjithshëm për monitorimin e informacionit që transmetojnë ose ruajnë, as detyrim për të kërkuar në mënyrë aktive fakte ose rrethana që tregojnë veprimtari të paligjshme.	F	
9.1	Neni 9 Urdhra për të vepruar kundër përmbajtjes së paligjshme Pas marrjes së një urdhri për të vepruar kundër një ose më shumë artikujve specifikë me përmbajtje të paligjshme, të lëshuar nga	1	9.1	Neni 9 Urdhrat për të vepruar kundër përmbajtjes së paligjshme 1.Me marrjen e një urdhëri për të vepruar kundër një ose më shumë elementëve specifikë të përmbajtjes së paligjshme, të lëshuar nga	F	

	autoritetet përkatëse gjyqësore ose administrative kombëtare, në bazë të ligjit të zbatueshëm të Unionit ose ligjit kombëtar në përputhje me ligjin e Unionit, ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit duhet të informojnë autoritetin që lëshon urdhrin, ose çdo autoritet tjetër të specifikuar në urdhër, për çdo efekt që i është dhënë urdhrit pa vonesë të panevojshme, duke specifikuar nëse dhe kur i është dhënë efekti urdhrit.			autoritetet gjyqësore ose administrative kompetente përkatëse, në bazë të legjislacionit kombëtar të zbatueshëm, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë pa vonesë autoritetin që lëshon urdhërin, ose çdo autoritet tjetër të përcaktuar në urdhër, për çdo efekt të dhënë urdhrit, duke specifikuar nëse dhe, kur ka hyrë në fuqi urdhëri.		
9.2	Shtetet Anëtare sigurojnë që, kur një urdhër i përmendur në paragrafin 1 i transmetohet ofruesit, ai përmbush të paktën kushtet e mëposhtme:	1	9.2	2.Urdhëri i përmendur në pikën 1, të këtij neni, përmbush të paktën kushtet e mëposhtme:	F	
9.2.a	(a) ai urdhër përmban elementët e mëposhtëm:	1	9.2.a	a) Urdhri përmban elementet si më poshtë:	F	
9.2.a.i	(i) një referencë për bazën ligjore sipas ligjit të Unionit ose atij kombëtar për urdhrin;	1	9.2.a.i	(i) një referencë të bazës ligjore për nxjerrjen e urdhërit sipas ligjit kombëtar;	F	
9.2.a.ii	(ii) një deklaratë arsyesh që shpjegojnë pse informacioni është përmbajtje e paligjshme, duke iu referuar një ose më shumë dispozitave specifike të ligjit të Unionit ose ligjit kombëtar në përputhje me ligjin e Unionit;	1	9.2.a.ii	(ii) një deklaratë të arsyetuar, që shpjegon pse informacioni është përmbajtje e paligjshme, dhe referencat e një ose më shumë dispozitave specifike ligjore sipas legjislacionit përkatës në fuqi;	F	
9.2.a.iii	(iii) informacion që identifikon autoritetin lëshues;	1	9.2.a.iii	(iii) informacionin për identifikimin e autoritetit kompetent që ka nxjerrë urdhërin;	F	
9.2.a.iv	(iv) informacion i qartë që i mundëson ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse të identifikojë dhe lokalizojë përmbajtjen e paligjshme në fjalë, siç është një ose më shumë URL të saktë dhe, kur është e nevojshme, informacion shtesë;	1	9.2.a.iv	iv.informacion të qartë, që i mundëson ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse, të identifikojë dhe lokalizojë përmbajtjen e paligjshme në fjalë, një ose më shumë adresa të sakta URL, si dhe kur është e nevojshme informacion shtesë;	F	
9.2.a.v	(v) informacion në lidhje me mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse dhe të marrësit të shërbimit që ka ofruar përmbajtjen;	1	9.2.a.v	v.informacion në lidhje me mekanizmat e korrigjimit në dispozicion të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse dhe të marrësit të shërbimit që ka dhënë përmbajtjen;	F	
9.2.a.vi	(vi) kur është e aplikueshme, informacion në lidhje me autoritetin që duhet të marrë informacionin në lidhje me efektin e dhënë urdhrave;	1	9.2.a.vi	vi.kur është e zbatueshme, informacion për autoritetin i cili informohet për efektin e urdhrave të dhënë;	F	
9.2.b	(b) fushëveprimi territorial i atij urdhri, në bazë të rregullave të zbatueshme të së drejtës së Unionit dhe të së drejtës kombëtare, duke përfshirë Kartën, dhe, kur është e rëndësishme, parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, është i kufizuar në atë që është rreptësisht e nevojshme për të arritur objektivin e tij;	1	9.2.b	b)fushën territoriale të atij urdhëri, në bazë të rregullave të zbatueshme të së drejtës kombëtare, dhe, kur është e nevojshme, parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, e cila kufizohet rreptësisht për aq sa është e nevojshme për të arritur objektivin e tij;	F	
9.2.c	(c) ai urdhër transmetohet në njërën nga gjuhët e deklaruara nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse sipas nenit 11(3) ose në një gjuhë	1	9.2.c	c)urdhëri hartohet në gjuhën shqipe nëse ofruesi është një shoqëri shqiptare dhe kur është një shoqëri e huaj, urdhri i përkthyer në	F	

	tjetër zyrtare të Shteteve Anëtare, të rënë dakord midis autoritetit që lëshon urdhrin dhe atij ofruesi, dhe dërgohet në pikën elektronike të kontaktit të caktuar nga ai ofrues, në përputhje me nenin 11; kur urdhri nuk është hartuar në gjuhën e deklaruar nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse ose në një gjuhë tjetër të rënë dakord dypalësh, urdhri mund të transmetohet në gjuhën e autoritetit që lëshon urdhrin, me kusht që të shoqërohet me një përkthim në gjuhën e deklaruar ose të rënë dakord dypalësh të të paktën elementëve të përcaktuar në pikat (a) dhe (b) të këtij paragrafi.			gjuhën angleze i dërgohet pikës së kontaktit online, të përcaktuar nga ofruesi i shërbimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 11, të këtij ligji.		
9.3	Autoriteti që lëshon urdhrin ose, kur është e aplikueshme, autoriteti i specifikuar në të, duhet ta transmetojë atë, së bashku me çdo informacion të marrë nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse në lidhje me efektin e dhënë atij urdhri, te Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale nga Shteti Anëtar i autoritetit lëshues.	1	9.3	3. Autoriteti që lëshon urdhërin ose, kur është e zbatueshme, autoriteti i specifikuar në të, informon Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale dhe i dërgon urdhërin së bashku me çdo informacion të marrë nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse, në lidhje me efektin e dhënë atij urdhëri.	F	
9.4	Pas marrjes së urdhrit nga autoriteti gjyqësor ose administrativ, Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i Shtetit Anëtar në fjalë, pa vonesë të panevojshme, ua transmeton një kopje të urdhrit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të gjithë Koordinatorëve të tjerë të Shërbimeve Dixhitale nëpërmjet sistemit të krijuar në përputhje me nenin 85.	1	9.4	4. Me qëllim sigurimin e zbatimit të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, i kërkon bashkëpunim Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale, ose autoriteteve të tjera përkatëse të shteteve të tjera.	F	
9.5	Jo më vonë se kur urdhri hyn në fuqi ose, kur është e aplikueshme, në kohën e caktuar nga autoriteti lëshues në urdhrin e tij, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të informojnë marrësin e shërbimit në fjalë për urdhrin e marrë dhe për efektin e dhënë atij. Ky informacion i dhënë marrësit të shërbimit duhet të përfshijë një deklaratë arsyesh, mundësitë për dëmshpërblim që ekzistojnë dhe një përshkrim të fushëveprimit territorial të urdhrit, në përputhje me paragrafin 2.	1	9.5	5. Jo më vonë se, momenti kur urdhërit i jepet efekt ose, sipas rastit, në kohën e parashikuar nga autoriteti lëshues në urdhërin e tij, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë marrësin e shërbimit në fjalë për urdhërin e marrë dhe për efektin që i është dhënë atij. Informacioni për marrësit e shërbimit përfshin një deklaratë të arsyeve, mundësitë për mjetet juridike, që ekzistojnë si dhe një përshkrim të fushës territoriale të zbatimit të urdhërit, në përputhje me pikën 2, të këtij neni.	F	
9.6	Kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen nuk cenojnë të drejtën kombëtare procedurale civile dhe penale.	1	9.6	6. Kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen, nuk cenojnë zbatimin e dispozitave të së drejtës procedurale civile dhe penale.	F	
10 .1	Neni 10 Urdhrat për dhënie informacioni	1	10 .1	Neni 10 Urdhrat për dhënie informacioni	F	

	Pas marrjes së një urdhri për të dhënë informacion specifik në lidhje me një ose më shumë përfitues individualë specifikë të shërbimit, të lëshuar nga autoritetet përkatëse gjyqësore ose administrative kombëtare në bazë të ligjit të zbatueshëm të Unionit ose ligjit kombëtar në përputhje me ligjin e Unionit, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet, pa vonesë të panevojshme, të informojnë autoritetin që lëshon urdhrin, ose çdo autoritet tjetër të specifikuar në urdhër, për marrjen e tij dhe për efektin e dhënë urdhrit, duke specifikuar nëse dhe kur i është dhënë efekti urdhrit.			1.Pas marrjes së një urdhëri për të dhënë informacion specifik, për një ose më shumë marrës individualë specifikë të shërbimit, të lëshuar nga autoritetet gjyqësore ose administrative kombëtare përkatëse, në bazë të legjislacionit kombëtar të zbatueshëm, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet, pa vonesë, të informojnë autoritetin që lëshon urdhrin, ose çdo autoritet tjetër të përcaktuar në urdhër, për marrjen e tij dhe për efektin që i është dhënë urdhërit, duke specifikuar nëse dhe kur iu dha efekt.		
10 .2.a	Shtetet Anëtare sigurojnë që, kur një urdhër i përmendur në paragrafin 1 i transmetohet ofruesit, ai përmbush të paktën kushtet e mëposhtme: a) të përmbajë:	1	10 .2.a	2.Urdhëri sipas pikës 1 të këtij neni, që i transmetohet ofruesit, duhet të plotësojë të paktën kushtet e mëposhtme: a) urdhëri përmban elementet si më poshtë:	F	
10 .2.a.i	(i) një referencë për bazën ligjore sipas ligjit të Unionit ose atij kombëtar për urdhrin;	1	10 .2.a.i	i.një referencë të bazës ligjore për urdhrin sipas ligjit kombëtar;	F	
10 .2.a.ii	(iii) informacion që identifikon autoritetin lëshues;	1	10 .2.a.ii	ii.informacion që identifikon autoritetin lëshues;	F	
10 .2.a.iii	(iv) informacion i qartë që i mundëson ofruesit të shërbimeve ndërmjetësuese të identifikojë marrësin ose marrësit specifikë për të cilët kërkohet informacion, siç janë një ose më shumë emra llogarish ose identifikues unikë;	1	10 .2.a.iii	iii.informacion të qartë që i mundëson ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse të identifikojë marrësin ose marrësit specifikë të shërbimeve, për të cilët kërkohet informacion, si një ose më shumë emra llogarish ose identifikues unikë;	F	
10 .2.a.iv	(iv) një deklaratë arsyesh që shpjegon objektivin për të cilin kërkohet informacioni dhe pse kërkesa për të dhënë informacionin është e nevojshme dhe proporcionale për të përcaktuar përputhshmërinë e marrësit të shërbimeve ndërmjetësuese me ligjin e zbatueshëm të Bashkimit ose ligjin kombëtar në përputhje me ligjin e Bashkimit, përveç nëse një deklaratë e tillë nuk mund të jepet për arsye që lidhen me parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të veprave penale;	1	10 .2.a.iv	iv.një deklaratë të arsyeve që shpjegon objektivin për të cilin kërkohet informacioni dhe arsyen pse kërkesa për të dhënë informacionin është e nevojshme dhe proporcionale, për të përcaktuar pajtueshmërinë nga marrësit e shërbimeve ndërmjetëse me ligjin kombëtar të zbatueshëm, përveç rastit kur kjo deklaratë nuk mund të jepet për arsye që lidhen me parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale;	F	
10 .2.a.v	(v) informacion në lidhje me mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion të ofruesit dhe përfituesve të shërbimit në fjalë;	1	10 .2.a.v	v.informacion në lidhje me mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion të ofruesit dhe të marrësve të shërbimit në fjalë;	F	
10 .2.a.vi	(vi) kur është e aplikueshme, informacion në lidhje me autoritetin që duhet të marrë informacionin në lidhje me efektin e dhënë urdhrave;	1	10 .2.a.vi	vi.aty ku është e zbatueshme, informacion për autoritetin që duhet të marrë informacionin për zbatimin e urdhrave.	F	

10 .2.b	(b) ky urdhër kërkon vetëm që ofruesi të japë informacionin e mbledhur tashmë për qëllimet e ofrimit të shërbimit dhe që është nën kontrollin e tij;	1	10 .2.b	b)urdhri kërkon vetëm që ofruesi të japë informacionin e mbledhur për qëllimet e ofrimit të shërbimit dhe që është nën kontrollin e tij;	F	
10 .2.c	(c) ai urdhër transmetohet në njërën nga gjuhët e deklaruara nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse sipas nenit 11(3) ose në një gjuhë tjetër zyrtare të Shteteve Anëtare, të rënë dakord midis autoritetit që lëshon urdhrin dhe ofruesit, dhe dërgohet në pikën elektronike të kontaktit të caktuar nga ai ofrues, në përputhje me nenin 11; kur urdhri nuk është hartuar në gjuhën e deklaruar nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse ose në një gjuhë tjetër të rënë dakord dypalësh, urdhri mund të transmetohet në gjuhën e autoritetit që lëshon urdhrin, me kusht që të shoqërohet me një përkthim në gjuhën e deklaruar ose të rënë dakord dypalësh të të paktën elementëve të përcaktuar në pikat (a) dhe (b) të këtij paragrafi.	1	10 .2.c	c)urdhëri përpilohet në gjuhën shqipe, nëse ofruesi është një shoqëri shqiptare, me një përkthim në gjuhën angleze nëse ofruesi është një shoqëri e huaj dhe i dërgohet pikës elektronike të kontaktit të caktuar nga ai ofrues, në përputhje me nenin 11, të këtij ligji.	F	
10 .3	Autoriteti që lëshon urdhrin ose, kur është e aplikueshme, autoriteti i specifikuar në të, duhet ta transmetojë atë, së bashku me çdo informacion të marrë nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse në lidhje me efektin e dhënë atij urdhri, te Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale nga Shteti Anëtar i autoritetit lëshues.	1	10 .3	3.Autoriteti lëshues i urdhrin ose, sipas rastit, autoriteti i përcaktuar në të, ia transmeton atë, së bashku me çdo informacion të marrë nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse në lidhje me efektin e dhënë atij urdhri, Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.	F	
10 .4	Pas marrjes së urdhrin nga autoriteti gjyqësor ose administrativ, Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i Shtetit Anëtar në fjalë, pa vonesë të panevojshme, u transmeton një kopje të urdhrin të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të gjithë Koordinatorëve të Shërbimeve Dixhitale nëpërmjet sistemit të krijuar në përputhje me nenin 85.	1	10 .4	4.Me qëllim sigurimin e zbatimit të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, kërkon bashkëpunimin e Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale, ose autoriteteve të tjera përkatëse nga shtetet e tjera.	F	
10 .5	Jo më vonë se kur urdhri hyn në fuqi, ose, kur është e aplikueshme, në kohën e caktuar nga autoriteti lëshues në urdhrin e tij, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të informojnë marrësin e shërbimit në fjalë për urdhrin e marrë dhe efektin e dhënë atij. Një informacion i tillë i dhënë marrësit të shërbimit duhet të përfshijë një deklaratë të arsyeve dhe mundësitë për dëmshpërblim që ekzistojnë, në përputhje me paragrafin 2.	1	10 .5	5.Jo më vonë se momenti kur urdhrin i jepet efekt ose, sipas rastit, në kohën e parashikuar nga autoriteti lëshues në urdhrin e tij, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë marrësin e shërbimit përkatës për urdhrin e marrë dhe efektin që i është dhënë atij. Një informacion i tillë i dhënë marrësit të shërbimit përfshin një deklaram të arsyeve dhe mundësitë për dëmshpërblim që ekzistojnë, në përputhje me pikën 2, të këtij neni.	F	
10 .6	Kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen nuk cenojnë të drejtën kombëtare procedurale civile dhe penale.	1	10 .6	6.Kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen, nuk cënojnë kërkesat e së drejtës procedurale civile dhe penale.	F	

11.1	Neni 11 Pikat e kontaktit për autoritetet e Shteteve Anëtare, Komisionin dhe Bordin Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse caktojnë një pikë të vetme kontakti për t'u mundësuar atyre të komunikojnë drejtpërdrejt, me mjete elektronike, me autoritetet e Shteteve Anëtare, Komisionin dhe Bordin e përmendur në nenin 61 për zbatimin e kësaj Rregulloreje.	1	11.1	Neni 11 Caktimi i pikave të kontaktit për autoritetet 1.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse caktojnë një pikë të vetme kontakti, për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me mjete elektronike, me autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë.	F	
11.2	Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të bëjnë publike informacionin e nevojshëm për të identifikuar dhe komunikuar lehtësisht me pikat e tyre të vetme të kontaktit. Ky informacion duhet të jetë lehtësisht i arritshëm dhe duhet të mbahet i përditësuar.	1	11.2	2.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse publikojnë informacionin e nevojshëm për të identifikuar lehtësisht dhe për të komunikuar me pikat e tyre të vetme të kontaktit. Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe përditësohet.	F	
11.3	Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të specifikojnë në informacionin e përmendur në paragrafin 2 gjuhën ose gjuhët zyrtare të Shteteve Anëtare të cilat, përveç një gjuhe që kuptohet gjerësisht nga numri më i madh i mundshëm i qytetarëve të Bashkimit, mund të përdoren për të komunikuar me pikat e tyre të kontaktit dhe të cilat duhet të përfshijnë të paktën një nga gjuhët zyrtare të Shtetit Anëtar në të cilin ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse ka selinë e tij kryesore ose ku banon ose është i vendosur përfaqësuesi i tij ligjor.	1	11.3	3.Autoritetet kompetente dhe gjyqësore komunikojnë me ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse në gjuhën shqipe, nëse ofruesi është një shoqëri shqiptare dhe në gjuhën angleze nëse është një shoqëri e huaj.	F	
12.1	Neni 12 Pikat e kontaktit për përfituesit e shërbimit Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të caktojnë një pikë të vetme kontakti për t'u mundësuar marrësit e shërbimit të komunikojnë drejtpërdrejt dhe shpejt me ta, me anë të mjeteve elektronike dhe në një mënyrë miqësore për përdoruesit, duke përfshirë edhe duke u lejuar marrësit e shërbimit të zgjedhin mjetet e komunikimit, të cilat nuk duhet të mbështeten vetëm në mjete të automatizuara.	1	12.1	Neni 12 Pikat e kontaktit për marrësit e shërbimit 1.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse caktojnë një pikë të vetme kontakti, për t'u mundësuar marrësve të shërbimit, të komunikojnë drejtpërdrejt dhe me shpejtësi me ta. Komunikimi bëhet nëpërmjet mjeteve elektronike dhe në mënyrë të lehtë për përdoruesin, përfshirë lejimin e marrësve të shërbimit të zgjedhin mjetet e komunikimit, që nuk mbështeten vetëm në mjete të automatizuara.	F	
12.2	Përveç detyrimeve të parashikuara në Direktivën 2000/31/KE, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të bëjnë publike informacionin e nevojshëm për marrësit e shërbimit në mënyrë që të identifikohen dhe të komunikojnë lehtësisht me pikat e tyre të vetme të kontaktit. Ky informacion duhet të jetë	1	12.2	2.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse bëjnë publik informacionin e nevojshëm për marrësit e shërbimit, në mënyrë që të identifikojnë lehtësisht dhe të komunikojnë me pikat e tyre të vetme të kontaktit. Informacion i publikuar është lehtësisht i aksesueshëm dhe përditësohet.	F	

	lehtësisht i arritshëm dhe duhet të mbahet i azhurnuar.					
13.1	Neni 13 Përfaqësuesi ligjor Ofruesit e shërbimeve ndërmjetësuese që nuk kanë një seli në Bashkim, por që ofrojnë shërbime në Bashkim, duhet të caktojnë, me shkrim, një person juridik ose fizik që të veprojë si përfaqësuesi i tyre ligjor në një nga Shtetet Anëtare ku ofruesi ofron shërbimet e tij.	1	13.1	Neni 13 Përfaqësuesi ligjor 1.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që nuk kanë një seli në Republikën e Shqipërisë, por që ofrojnë shërbime në Republikën e Shqipërisë, caktojnë me shkrim, një person juridik ose fizik që vepron si përfaqësuesi i tyre ligjor për Republikën e Shqipërisë. Për qëllimet e këtij ligji, përfaqësuesi ligjor për Republikën e Shqipërisë mund të jetë I vendosur në Shqipëri, ose në një shtet anëtar të Bashkimit Europian.	F	
13.2	Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të mandatojnë përfaqësuesit e tyre ligjorë me qëllim që të adresohen përveç ose në vend të ofruesve të tillë, nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisioni dhe Bordi, për të gjitha çështjet e nevojshme për marrjen, pajtueshmërinë dhe zbatimin e vendimeve të lëshuara në lidhje me këtë Rregullore. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet t'u japin përfaqësuesve të tyre ligjorë kompetencat e nevojshme dhe burimet e mjaftueshme për të garantuar bashkëpunimin e tyre efikas dhe në kohë me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionin dhe Bordin, dhe për t'u pajtuar me vendime të tilla.	1	13.2	2.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse autorizojnë përfaqësuesit e tyre ligjorë, me qëllim që, për të gjitha çështjet e nevojshme për marrjen, respektimin dhe zbatimin e vendimeve të nxjerra në lidhje me këtë ligj, nga autoritetet administrative ose gjyqësore kompetente dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale të Republikës së Shqipërisë, t'u drejtohen atyre përveç ofruesit ose në vend të ofruesit. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse pajisin përfaqësuesit e tyre ligjorë me kompetencat e nevojshme dhe burime të mjaftueshme për të garantuar bashkëpunimin efikas dhe në kohë me autoritetet gjyqësore, autoritetet administrative kompetente dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale të Republikës së Shqipërisë, si dhe për të respektuar këto vendime.	F	
13.3	Do të jetë e mundur që përfaqësuesi ligjor i caktuar të mbahet përgjegjës për mosrespektimin e detyrimeve sipas kësaj Rregulloreje, pa cenuar përgjegjësinë dhe veprimet ligjore që mund të iniciohen kundër ofruesit të shërbimeve ndërmjetësuese.	1	13.3	3.Përfaqësuesi ligjor i caktuar është përgjegjës për mosrespektimin e detyrimeve sipas këtij ligji, pa cenuar përgjegjësinë dhe veprimet ligjore që mund të iniciohen kundër ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse.	F	
13.4	Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet t'ia njoftojnë Koordinatorit të Shërbimeve Dixhitale në Shtetin Anëtar ku banon ose është i vendosur ai përfaqësues ligjor emrin, adresën postare, adresën e email-it dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të tyre ligjor.	1	13.4	4.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse njoftojnë Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale në Republikën e Shqipërisë për emrin, adresën postare, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të tyre ligjor.	F	

13.5	Caktimi i një përfaqësuesi ligjor brenda Bashkimit sipas paragrafit 1 nuk përbën një vendosje në Bashkim.	1	13.5	5.Caktimi i një përfaqësuesi ligjor në përputhje me pikën 1, të këtij neni nuk përbën themelim në Republikën e Shqipërisë.	F	
14.1	Neni 14 Kushtet dhe afatet Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të përfshijnë informacion mbi çdo kufizim që ata vendosin në lidhje me përdorimin e shërbimit të tyre në lidhje me informacionin e ofruar nga marrësit e shërbimit, në kushtet dhe afatet e tyre. Ky informacion duhet të përfshijë informacion mbi çdo politikë, procedurë, masë dhe mjet të përdorur për qëllimin e moderimit të përmbajtjes, duke përfshirë vendimmarrjen algoritmike dhe shqyrtimin njerëzor, si dhe rregullat e procedurës së sistemit të tyre të brendshëm të trajtimit të ankesave. Ai duhet të përcaktohet në një gjuhë të qartë, të thjeshtë, të kuptueshme, miqësore për përdoruesit dhe të padiskutueshme, dhe duhet të jetë i disponueshëm publikisht në një format lehtësisht të arritshëm dhe të lexueshëm nga makina.	1	14.1	Neni 14 Kushtet dhe afatet 1.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse në termat dhe kushtet e tyre për ofrimin e shërbimeve, përfshijnë informacion mbi çdo kufizim që ata vendosin në lidhje me përdorimin e shërbimit të tyre për sa i përket informacionit të ofruar nga marrësit e shërbimit. Ky informacion përfshin informacion mbi çdo politikë, procedurë, masë dhe mjet të përdorur për qëllimin e moderimit të përmbajtjes, përfshirë vendimmarrjen algoritmike dhe shqyrtimin njerëzor, si dhe rregullat e procedurës së sistemit të tyre të brendshëm të trajtimit të ankesave. Informacioni paraqitet në gjuhë të qartë, të thjeshtë, të kuptueshme, miqësore për përdoruesin dhe pa ekuivoke. Ky informacion publikohet në një format lehtësisht të aksesueshëm dhe të lexueshëm nga pajisjet.	F	
14.2	Ofruesit e shërbimeve ndërmjetësuese duhet të informojnë përfituesit e shërbimit për çdo ndryshim të rëndësishëm në termat dhe kushtet.	1	14.2	2.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë marrësit e shërbimit për çdo ndryshim të rëndësishëm të kushteve dhe afateve.	F	
14.3	Kur një shërbim ndërmjetësimi u drejtohet kryesisht të miturve ose përdoret kryesisht prej tyre, ofruesi i atij shërbimi ndërmjetësimi duhet të shpjegojë kushtet dhe çdo kufizim mbi përdorimin e shërbimit në një mënyrë që të miturit ta kuptojnë.	1	14.3	3.Kur një shërbim ndërmjetës u drejtohet kryesisht të miturve, ose përdoret kryesisht prej tyre, ofruesi i shërbimit ndërmjetës shpjegon kushtet për përdorimin e shërbimit, si dhe çdo kufizim mbi to, në një mënyrë të kuptueshme për të miturit.	F	
14.4	Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të veprojnë në mënyrë të kujdesshme, objektive dhe proporcionale në zbatimin dhe zbatimin e kufizimeve të përmendura në paragrafin 1, duke i kushtuar vëmendje të duhur të drejtave dhe interesave legjitime të të gjitha palëve të përfshira, duke përfshirë të drejtat themelore të përfituesve të shërbimit, siç janë liria e shprehjes, liria dhe pluralizmi i medias, si dhe të drejtat dhe liritë e tjera themelore të sanksionuara në Kartë.	1	14.4	4.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, veprojnë në mënyrë të kujdesshme, objektive dhe proporcionale, në zbatimin dhe ekzekutimin e kufizimeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, duke marrë në konsideratë të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të përfshira, përfshirë të drejtat themelore të marrësve të shërbimit, si liria e shprehjes, liria dhe pluralizmi i medias, si dhe të drejta dhe liri të tjera themelore, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.	F	

14.5	Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online duhet t'u ofrojnë marrësve të shërbimeve një përmbledhje koncize, lehtësisht të arritshme dhe të lexueshme nga makina të termave dhe kushteve, duke përfshirë mjetet juridike dhe mekanizmat e disponueshëm të dëshmipërblimit, në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.	1	14.5	5.Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, u ofrojnë marrësve të shërbimeve një përmbledhje koncize, lehtësisht të aksesueshme dhe të lexueshme nga pajisjet të kushteve dhe termave, përfshirë mjetet e disponueshme të ankimit dhe mekanizmat e zhdëmtimit, në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.	F	
14.6	Platformat shumë të mëdha online dhe motorët shumë të mëdhenj të kërkimit online sipas kuptimit të nenit 33 duhet të publikojnë termat dhe kushtet e tyre në gjuhët zyrtare të të gjitha shteteve anëtare në të cilat ofrojnë shërbimet e tyre.	1	14.6	6.Platformat shumë të mëdha online dhe motorët e kërkimit online shumë të mëdhenj, sipas nenit 33, të këtij ligji, publikojnë kushtet dhe afatet e tyre në gjuhët zyrtare të të gjitha Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, ku ato ofrojnë shërbimet e tyre.	F	
15.1	Neni 15 Detyrimet e raportimit të transparencës për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet të bëjnë të disponueshme publikisht, në një format të lexueshëm nga makina dhe në një mënyrë lehtësisht të arritshme, të paktën një herë në vit, raporte të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme mbi çdo moderim përmbajtjeje në të cilin janë angazhuar gjatë periudhës përkatëse. Këto raporte duhet të përfshijnë, në veçanti, informacion mbi sa vijon, sipas rastit:	1	15.1	Neni 15 Detyrimet e raportimit të transparencës për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse 1.Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse vënë në dispozicion të publikut, në një format të lexueshëm nga pajisjet dhe në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme, të paktën një herë në vit, raporte të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme mbi çdo shqyrtim përmbajtjeje ku ata janë angazhuar gjatë periudhës përkatëse. Këto raporte përfshijnë, në veçanti, informacion mbi sa vijon, sipas rastit:	F	
15.1.a	(a) për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, numri i urdhrave të marra nga autoritetet e Shteteve Anëtare, duke përfshirë urdhrat e lëshuar në përputhje me nenet 9 dhe 10, të kategorizuara sipas llojit të përmbajtjes së paligjshme në fjalë, Shtetit Anëtar që lëshon urdhrin dhe kohës mesatare të nevojshme për të informuar autoritetin që lëshon urdhrin, ose çdo autoritet tjetër të specifikuar në urdhër, për marrjen e tij dhe për ta vënë në fuqi urdhrin;	1	15.1.a	a)për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, numrin e urdhrave të marra nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë urdhrat e nxjerra në përputhje me nenet 9 dhe 10, të këtij ligji, të kategorizuara sipas llojit të përmbajtjes së paligjshme në fjalë, autoritetit që nxjerr urdhërin, dhe kohën mesatare të nevojshme për të njoftuar autoritetin që nxjerr urdhërin, ose çdo autoritet tjetër të përcaktuar në urdhër, për marrjen dhe zbatimin e ti;	F	
15.1.b	(b) për ofruesit e shërbimeve të strehimit, numri i njoftimeve të paraqitura në përputhje me Nenin 16, të kategorizuara sipas llojit të përmbajtjes së supozuar të paligjshme në fjalë, numri i njoftimeve të paraqitura nga sinjalizuesit e besuar, çdo veprim i ndërmarrë në përputhje me njoftimet duke dalluar nëse veprimi është ndërmarrë në bazë të ligjit apo të kushteve dhe afateve të ofruesit, numri i njoftimeve të përpunuara duke përdorur mjete të	1	15.1.b	b)për ofruesit e shërbimeve të hostimit, numrin e njoftimeve të paraqitura në përputhje me nenin 16, të këtij ligji, të kategorizuara sipas llojit të përmbajtjes së pretenduar të paligjshme në fjalë, numrin e njoftimeve të paraqitura nga sinjalizues të besuar, çdo veprim të ndërmarrë në bazë të njoftimeve, duke dalluar nëse veprimi është ndërmarrë në bazë të ligjit, ose të termave dhe kushteve të ofruesit, numrin e njoftimeve të përpunuara, duke përdorur mjete	F	

	automatizuara dhe koha mesatare e nevojshme për ndërmarrjen e veprimit;			të automatizuara dhe kohën mesatare të nevojshme për ndërmarrjen e veprimit;		
15.1.c	(c) për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, informacion kuptimplotë dhe i kuptueshëm në lidhje me moderimin e përmbajtjes të ndërmarrë me iniciativën e vetë ofruesve, duke përfshirë përdorimin e mjeteve të automatizuara, masat e marra për të ofruar trajnim dhe ndihmë për personat përgjegjës për moderimin e përmbajtjes, numrin dhe llojin e masave të marra që ndikojnë në disponueshmërinë, dukshmërinë dhe aksesin e informacionit të ofruar nga marrësit e shërbimit dhe aftësinë e marrësve për të ofruar informacion përmes shërbimit, si dhe kufizime të tjera të lidhura me shërbimin; informacioni i raportuar duhet të kategorizohet sipas llojit të përmbajtjes së paligjshme ose shkeljes së kushteve dhe afateve të ofruesit të shërbimit, sipas metodës së zbulimit dhe sipas llojit të kufizimit të aplikuar;	1	15.1.c	c)për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, informacion kuptimplotë dhe të kuptueshëm për shqyrtimin e përmbajtjes, të kryer me nismën e ofruesve, përfshirë përdorimin e mjeteve të automatizuara, masat e marra për të ofruar trajnim dhe ndihmë për personat përgjegjës për shqyrtimin e përmbajtjes, numrin dhe llojin e masave të marra që ndikojnë në disponueshmërinë, dukshmërinë dhe aksesueshmërinë e informacionit të ofruar nga marrësit e shërbimit dhe aftësinë e marrësve për të ofruar informacion nëpërmjet shërbimit dhe kufizime të tjera të lidhura të shërbimit; informacioni i raportuar kategorizohet sipas llojit të përmbajtjes së paligjshme, ose shkeljes së termave dhe kushteve të ofruesit të shërbimit, sipas metodës së zbulimit dhe sipas llojit të kufizimit të zbatuar;	F	
15.1.d	(d) për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, numri i ankesave të marra përmes sistemeve të brendshme të trajtimit të ankesave në përputhje me termat dhe kushtet e ofruesit dhe përveç kësaj, për ofruesit e platformave online, në përputhje me nenin 20, baza për këto ankesa, vendimet e marra në lidhje me këto ankesa, koha mesatare e nevojshme për marrjen e këtyre vendimeve dhe numri i rasteve kur këto vendime u rrëzuan;	1	15.1.d	d)për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, numrin e ankesave të marra nëpërmjet sistemeve të brendshme të trajtimit të ankesave, në përputhje me kushtet dhe afatet e ofruesit dhe përveç kësaj, për ofruesit e platformave online, në përputhje me nenin 20, të këtij ligji, bazën për ankesat, vendimet e marra në lidhje me to, kohën mesatare të nevojshme për marrjen e vendimeve dhe numrin e rasteve kur ka pasur ndryshime të vendimeve;	F	
15.1.e	(e) çdo përdorim i mjeteve të automatizuara për qëllime të moderimit të përmbajtjes, duke përfshirë një përshkrim cilësor, një specifikim të qëllimeve të sakta, tregues të saktësisë dhe shkallës së mundshme të gabimit të mjeteve të automatizuara të përdorura në përmbushjen e këtyre qëllimeve, si dhe çdo masë mbrojtëse të zbatuar.	1	15.1.dh	dh) çdo përdorim të mjeteve të automatizuara për qëllimin e shqyrtimit të përmbajtjes, duke përfshirë një përshkrim cilësor, një specifikim të qëllimeve të sakta, tregues të saktësisë dhe shkallës së mundshme të gabimit të mjeteve të automatizuara të përdorura në përmbushjen e këtyre qëllimeve dhe çdo masë mbrojtëse të zbatuar.	F	
15.2	Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që kualifikohen si ndërmarrje mikro ose të vogla siç përcaktohet në Rekomandimin 2003/361/KE dhe që nuk janë platforma shumë të mëdha online sipas kuptimit të nenit 33 të kësaj Rregulloreje.	1	15.2	2.Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që kualifikohen si ndërmarrje të vogla dhe mikrondërmarrje, sipas ligjit nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.	F	

15.3	Komisioni mund të miratojë akte zbatuese për të përcaktuar modele në lidhje me formën, përmbajtjen dhe detaje të tjera të raporteve në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, duke përfshirë periudhat e harmonizuara të raportimit. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 88.	1	15.3	1. 3. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, miraton aktet zbatuese mbi përcaktimin e modeleve lidhur me formën, përmbajtjen dhe hollësi të tjera të raporteve në përputhje me pikën 1, të këtij neni, përfshirë dhe periudhat e raportimit të harmonizuar me praktikën e miratuar nga Komisioni Evropian.	F	
16.1	Neni 16 Mekanizmat e njoftimit dhe veprimit Ofruesit e shërbimeve të hostimit duhet të vendosin mekanizma që i lejojnë çdo individ ose subjekti t'i njoftojë ata për praninë në shërbimin e tyre të informacioneve specifike që individ ose subjekti i konsideron si përmbajtje të paligjshme. Këto mekanizma duhet të jenë të lehta për t'u aksesuar dhe miqësore për përdoruesit, dhe duhet të lejojnë paraqitjen e njoftimeve ekskluzivisht me mjete elektronike.	1	16.1	Neni 16 Mekanizmat e njoftimit dhe veprimit 1.Ofruesit e shërbimeve të hostimit, vendosin mekanizma për të lejuar çdo individ ose subjekt t'i njoftojë ofruesit mbi praninë në shërbimin e tyre, të elementeve specifike të informacionit që individ ose subjekti, i konsideron përmbajtje të paligjshme. Këto mekanizma janë lehtësisht të aksesueshëm dhe të lehtë për përdoruesin dhe lejojnë paraqitjen e njoftimeve ekskluzivisht me mjete elektronike.	F	
16.2	Mekanizmat e përmendur në paragrafin 1 duhet të jenë të tillë që të lehtësojnë dorëzimin e njoftimeve mjaftueshëm të sakta dhe të argumentuara në mënyrë adekuate. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të strehimit duhet të marrin masat e nevojshme për të mundësuar dhe lehtësuar dorëzimin e njoftimeve që përmbajnë të gjithë elementët e mëposhtëm:	1	16.2	2.Mekanizmat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, lehtësojnë paraqitjen e njoftimeve mjaftueshëm të sakta dhe të mirëargumentuara. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të hostimit marrin masat e nevojshme për të mundësuar dhe për të lehtësuar paraqitjen e njoftimeve që përmbajnë të gjithë elementët e mëposhtëm:	F	
16.2.a	(a) një shpjegim të mjaftueshëm të argumentuar të arsyeve pse individ ose subjekti pretendon se informacioni në fjalë është përmbajtje e paligjshme;	1	16.2.a	a)një shpjegim të mirëargumentuar të arsyeve pse individ ose subjekti pretendon se informacioni në fjalë është përmbajtje e paligjshme;	F	
16.2.b	(b) një tregues të qartë të vendndodhjes së saktë elektronike të atij informacioni, siç është URL-ja ose URL-të e sakta, dhe, kur është e nevojshme, informacion shtesë që mundëson identifikimin e përmbajtjes së paligjshme të përshtatur për llojin e përmbajtjes dhe për llojin specifik të shërbimit hosting;	1	16.2.b	b)një paraqitje të qartë të vendndodhjes së saktë elektronike të atij informacioni, si URL-ja e saktë ose disa URL të sakta dhe kur është e nevojshme, informacione shtesë që mundësojnë identifikimin e përmbajtjes së paligjshme të përshtatura sipas llojit të përmbajtjes dhe llojit specifik të shërbimit të hostimit;	F	
16.2.c	(c) emrin dhe adresën e email-it të individit ose subjektit që paraqet njoftimin, përveç në rastin e informacionit që konsiderohet se përfshin një nga veprat penale të përmendura në nenet 3 deri në 7 të Direktivës 2011/93/BE;	1	16.2.c	c)emrin dhe adresën postës elektronike të individit ose entitetit që paraqet njoftimin, përveç në rastin e informacionit që konsiderohet se përfshin një nga veprat penale të përmendura në nenet 3 deri në 7 të Direktivës 2011/93/EU, një vepër penale që lidhet me	F	

				abuzimin seksual të të miturve, shfrytëzimin seksual të të miturve, pornografinë e fëmijëve, joshjen e të miturve për qëllime seksuale ose vepra të tjera penale me përmbytje të ngjashme, si dhe nxitjen, ndihmën, bashkëpunimin dhe tentativën për të kryer veprat penale të sipërpërmendura;		
16.2.d	(d) një deklaratë që konfirmon bindjen e mirëfilltë të individit ose subjektit që paraqet njoftimin se informacioni dhe pretendimet e përfshira në të janë të sakta dhe të plota.	1	16.2.ç	ç) një deklaratë që konfirmon besimin në mirëbesim të individit, ose entitetit që paraqet njoftimin, se informacioni dhe pretendimet e përfshira në të, janë të sakta dhe të plota.	F	
16.3	Njoftimet e përmendura në këtë nen konsiderohen se sjellin njohuri ose ndërgjegjësim aktual për qëllimet e nenit 6 në lidhje me artikullin specifik të informacionit në fjalë, kur ato i lejojnë një ofruesi të kujdesshëm të shërbimeve të strehimit të identifikojë paligjshmërinë e aktivitetit ose informacionit përkatës pa një shqyrtim të hollësishëm ligjor.	1	16.3	3.Njoftimet e cituara në këtë nen, konsiderohen se sjellin njohuri ose ndërgjegjësim faktik për qëllimet e nenit 6, të këtij ligji, në lidhje me elementin specifik të informacionit në fjalë, kur ato i lejojnë një ofruesi të kujdesshëm të shërbimeve të hostimit të identifikojë paligjshmërinë e veprimtarisë, ose informacionit përkatës, pa një shqyrtim të hollësishëm ligjor.	F	
16.4	Kur njoftimi përmban informacionin elektronik të kontaktit të individit ose subjektit që e ka paraqitur atë, ofruesi i shërbimeve të strehimit duhet, pa vonesë të panevojshme, t'i dërgojë atij individ ose subjekti një konfirmim të marrjes së njoftimit.	1	16.4	4.Kur njoftimi përmban informacionin elektronik të kontaktit të individit, ose entitetit që e ka paraqitur atë, ofruesi i shërbimeve të hostimit i dërgon menjëherë, individit ose entitetit të interesuar, një konfirmim për marrjen e njoftimit..	F	
16.5	Ofruesi gjithashtu, pa vonesë të panevojshme, duhet të njoftojë atë individ ose subjekt për vendimin e tij në lidhje me informacionin me të cilin lidhet njoftimi, duke dhënë informacion mbi mundësitë për dëshmipërblim në lidhje me atë vendim.	1	16.5	5.Ofruesi gjithashtu, njofton menjëherë individin ose entitetin për vendimin e tij, për informacionin me të cilin lidhet njoftimi, duke dhënë informacion mbi mundësitë për mjete juridike për vendimin.	F	
16.6	Ofruesit e shërbimeve të hostimit duhet të përpunojnë çdo njoftim që marrin sipas mekanizmave të përmendur në paragrafin 1 dhe të marrin vendimet e tyre në lidhje me informacionin me të cilin lidhen njoftimet, në një mënyrë të shpejtë, të kujdesshme, jo-arbitrare dhe objektive. Kur përdorin mjete të automatizuara për atë përpunim ose vendimmarrje, ata duhet të përfshijnë informacion mbi një përdorim të tillë në njoftimin e përmendur në paragrafin 5.	1	16.6	6.Ofruesit e shërbimeve të hostimit përpunojnë çdo njoftim që marrin sipas mekanizmave të përmendur në pikën 1, të këtij neni dhe marrin vendimet e tyre për informacionin me të cilin lidhen njoftimet, në një mënyrë koherente, të kujdesshme, jo arbitrarë dhe objektive. Kur ata përdorin mjete të automatizuara për përpunimin ose vendimmarrjen, përfshijnë informacion për një përdorim të tillë në njoftimin e përmendur në pikën 5, të këtij neni.	F	
17.1	Neni 17 Deklarata e arsyeve	1	17.1	Neni 17 Deklarata e arsyeve	F	

	Ofruesit e shërbimeve të hostimit duhet t'u japin një deklaratë të qartë dhe specifike arsyesh çdo marrësi të prekur të shërbimit për cilindo nga kufizimet e mëposhtme të vendosura me arsyetimin se informacioni i ofruar nga marrësi i shërbimit është përmbajtje e paligjshme ose e papajtueshme me termat dhe kushtet e tyre:			1.Ofruesit e shërbimeve të hostimit, u japin marrësve të shërbimit, një deklaratë të qartë dhe specifike të arsyeve për secilin nga kufizimet e mëposhtme, të bazuara mbi faktin se informacioni i ofruar nga marrësi i shërbimit, përbën përmbajtje të paligjshme, ose është i papajtueshëm me termat dhe kushtet e tyre:		
17.1.a	(a) çdo kufizim të dukshmërisë së informacioneve specifike të ofruara nga marrësi i shërbimit, duke përfshirë heqjen e përmbajtjes, pamundësimin e aksesit në përmbajtje ose uljen e nivelit të përmbajtjes;	1	17.1.a	a) çdo kufizim të dukshmërisë së elementeve specifike të informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit, përfshirë heqjen e përmbajtjes, çaktivizimin e aksesit në përmbajtje, ose reduktimin e caktimit të prioriteteve të përmbajtjes;	F	
17.1.b	(b) pezullim, ndërprerje ose kufizim tjetër i pagesave monetare;	1	17.1.b	b) pezullimin, ndërprerjen ose kufizime të tjera të pagesave monetare;	F	
17.1.c	(c) pezullimin ose ndërprerjen e ofrimit të shërbimit tërësisht ose pjesërisht;	1	17.1.c	c) pezullimin ose ndërprerjen tërësisht ose pjesërisht, të ofrimit të shërbimit;	F	
17.1.d	(d) pezullimin ose mbylljen e llogarisë së marrësit të shërbimit.	1	17.1.ç	ç) pezullimin ose mbylljen e llogarisë së marrësit të shërbimit.	F	
17.2	Paragrafi 1 zbatohet vetëm kur të dhënat përkatëse të kontaktit elektronik janë të njohura për ofruesin. Ai zbatohet më së voni nga data kur vendoset kufizimi, pavarësisht arsyes ose mënyrës se si është vendosur. Paragrafi 1 nuk zbatohet kur informacioni është përmbajtje mashtruese komerciale me volum të lartë.	1	17.2	2.Pika 1, e këtij neni, zbatohet vetëm në rastet kur të dhënat elektronike përkatëse të kontaktit, janë të njohura për ofruesin, dhe jo më vonë se data në të cilën vendoset kufizimi, pavarësisht nga arsyeja ose mënyra e vendosjes së tij. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet kur informacioni përbën një përmbajtje tregtare mashtruese me shtrirje të gjërë.	F	
17.3	Deklarata e arsyeve të përmendura në paragrafin 1 duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:	1	17.3	3.Deklarata e arsyeve e përmendur në pikën 1, të këtij neni, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:	F	
17.3.a	(a) informacion nëse vendimi përfshin heqjen, pamundësimin e aksesit në të, uljen e nivelit ose kufizimin e dukshmërisë së informacionit, ose pezullimin ose ndërprerjen e pagesave monetare që lidhen me atë informacion, ose vendos masa të tjera të përmendura në paragrafin 1 në lidhje me informacionin, dhe, kur është e nevojshme, fushëveprimin territorial të vendimit dhe kohëzgjatjen e tij;	1	17.3.a	a) informacion nëse vendimi sjell heqjen, çaktivizimin e aksesit, uljen e renditjes ose kufizimin e dukshmërisë së informacionit, ose pezullimin apo ndërprerjen e pagesave monetare të lidhura me atë informacion, ose vendos masa të tjera të përmendura në pikën 1, të këtij neni, në lidhje me informacionin, si dhe, kur është e aplikueshme, shtrirjen territoriale të vendimit dhe kohëzgjatjen e tij;	F	
17.3.b	(b) faktet dhe rrethanat në të cilat është mbështetur marrja e vendimit, duke përfshirë, kur është e nevojshme, informacionin nëse vendimi është marrë në përputhje me një njoftim të paraqitur në përputhje me nenin 16 ose bazuar në hetime vullnetare me iniciativë të vetë-	1	17.3.b	b) faktet dhe rrethanat mbi të cilat është mbështetur marrja e vendimit, përfshirë, kur është e aplikueshme, informacion nëse vendimi është marrë në bazë të një njoftimi të paraqitur në përputhje me nenin 16, të këtij ligji, ose mbi	F	

	kërkuar dhe, kur është absolutisht e nevojshme, identitetin e njoftuesit;			bazën e hetimeve vullnetare, si dhe, kur është rreptësisht e nevojshme, identitetin e njoftuesit;		
17.3.c	(c) kur është e aplikueshme, informacion mbi përdorimin e mjeteve të automatizuara në marrjen e vendimit, duke përfshirë informacionin nëse vendimi është marrë në lidhje me përmbajtjen e zbuluar ose të identifikuar duke përdorur mjete të automatizuara;	1	17.3.c	c) sipas rastit, informacion mbi përdorimin e mjeteve të automatizuara në marrjen e vendimit, përfshirë informacion nëse vendimi është marrë në lidhje me përmbajtjen evidente ose identifikuar nëpërmjet mjeteve të automatizuara;	F	
17.3.d	(d) kur vendimi ka të bëjë me përmbajtje të supozuar të paligjshme, një referencë për bazën ligjore mbi të cilën mbështetet dhe shpjegime se pse informacioni konsiderohet si përmbajtje e paligjshme mbi atë bazë;	1	17.3.ç	ç) referimin ndaj bazës ligjore mbi të cilën është mbështetur vendimi, kur vendimi lidhet me përmbajtje të pretenduar si të paligjshme, si dhe shpjegime mbi arsyet pse informacioni konsiderohet përmbajtje e paligjshme mbi atë bazë;	F	
17.3.e	(e) kur vendimi bazohet në papajtueshmërinë e pretenduar të informacionit me termat dhe kushtet e ofruesit të shërbimeve të hostimit, një referencë për bazën kontraktuale në të cilën është mbështetur dhe shpjegime se pse informacioni konsiderohet i papajtueshëm me atë bazë;	1	17.3.d	d) referimin ndaj bazës kontraktore mbi të cilën është mbështetur vendimi, si dhe shpjegime mbi arsyet pse informacioni konsiderohet i papajtueshëm me atë bazë, kur vendimi bazohet në papajtueshmërinë e pretenduar të informacionit me termat dhe kushtet e ofruesit të shërbimeve të hostimit;	F	
17.3.f	(f) informacion i qartë dhe i lehtë për t'u përdorur mbi mundësitë për dëmshpërblim në dispozicion të marrësit të shërbimit në lidhje me vendimin, në veçanti, kur është e aplikueshme nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të trajtimit të ankesave, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës dhe dëmshpërblimit gjyqësor.	1	17.3.dh	dh) informacion të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm për përdoruesin mbi mundësitë e ankimit ose të mjeteve të mbrojtjes juridike në dispozicion të marrësit të shërbimit, në lidhje me vendimin, veçanërisht, kur është e aplikueshme, nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të trajtimit të ankesave, zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve dhe mjeteve gjyqësore të mbrojtjes.	F	
17.4	Informacioni i ofruar nga ofruesit e shërbimeve të hostimit në përputhje me këtë nen duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm dhe sa më i saktë dhe specifik që të jetë e mundur në rrethanat e dhëna. Informacioni, në veçanti, duhet të jetë i tillë që t'i lejojë në mënyrë të arsyeshme marrësit të shërbimit në fjalë të ushtrojë në mënyrë efektive mundësitë për dëmshpërblim të përmendura në paragrafin 3, pika (f).	1	17.4	4. Informacioni i dhënë nga ofruesit e shërbimeve të hostimit në përputhje me këtë nen, duhet të jetë i qartë, lehtësisht i kuptueshëm dhe sa më i saktë dhe specifik që të jetë e arsyeshme, sipas rrethanave konkrete. Në veçanti, informacioni duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë në mënyrë të arsyeshme marrësit të prekur të shërbimit, të ushtrojë në mënyrë efektive mundësitë e ankimit, ose të mbrojtjes juridike të përmendura në gjermën f, të pikës 3, të këtij neni.	F	
17.5	Ky nen nuk zbatohet për asnjë urdhër të përmendur në nenin 9.	1	17.5	5. Ky nen nuk zbatohet për urdhrat e përmendur në nenin 9, të këtij ligji.	F	
18.1	Neni 18	1	18.1	Neni 18	F	

	Njoftimi mbi dyshimet për vepra penale Kur një ofrues i shërbimeve të strehimit vihet në dijeni të ndonjë informacioni që ngre dyshimin se ka ndodhur, po ndodh ose ka të ngjarë të ndodhë një vepër penale që përfshin kërcënim për jetën ose sigurinë e një personi ose personave, ai duhet të informojë menjëherë autoritetet ligjzbatuese ose gjyqësore të Shtetit Anëtar ose Shteteve Anëtare përkatëse për dyshimin e tij dhe të ofrojë të gjithë informacionin përkatës në dispozicion.			Njoftimi mbi dyshimet për vepra penale 1.Kur një ofrues i shërbimeve të hostimit, merr dijeni për çdo informacion që ngre dyshime se një vepër penale, e cila përfshin kërcënim ndaj jetës ose sigurisë së një ose më shumë personave, është kryer, është duke u kryer, ose ka gjasa të kryhet , ai njofton menjëherë autoritetet e zbatimit të ligjit ose autoritetet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.		
18.2	Kur ofruesi i shërbimeve të strehimit nuk mund ta identifikojë me siguri të arsyeshme Shtetin Anëtar në fjalë, ai duhet të informojë autoritetet ligjzbatuese të Shtetit Anëtar në të cilin është vendosur ose ku banon ose është vendosur përfaqësuesi i tij ligjor, ose të informojë Europolin, ose të dyja. Për qëllimet e këtij Neni, Shteti Anëtar në fjalë do të jetë Shteti Anëtar në të cilin dyshohet se ka ndodhur, se po ndodh ose ka të ngjarë të ndodhë vepra penale, ose Shteti Anëtar ku banon ose ndodhet i dyshuari për kryerjen e veprës penale, ose Shteti Anëtar ku banon ose ndodhet viktimë e veprës penale të dyshuar.	1	18.2	2.Kur ofruesi i shërbimeve të hostimit, nuk mund të përcaktojë me siguri të arsyeshme, nëse vepra penale është kryer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por ka dyshime të arsyeshme lidhur me këtë, ai njofton autoritetin kompetent, autoritetin gjyqësor dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale të Republikës së Shqipërisë.	F	
19.1	Neni 19 Përfshirjet për ndërmarrjet mikro dhe të vogla Ky Seksion, me përjashtim të Nenit 24(3) të tij, nuk do të zbatohet për ofruesit e platformave online që kualifikohen si ndërmarrje mikro ose të vogla siç përcaktohet në Rekomandimin 2003/361/KE. y Seksion, me përjashtim të Nenit 24(3) të tij, nuk do të zbatohet për ofruesit e platformave online që më parë kualifikoheshin për statusin e një ndërmarrjeje mikro ose të vogël siç përcaktohet në Rekomandimin 2003/361/KE gjatë 12 muajve pas humbjes së këtij statusi në përputhje me Nenin 4(2) të tij, përveç kur ato janë platforma shumë të mëdha online në përputhje me Nenin 33.	1	19.1	Neni 19 Përfshirjet për ndërmarrjet mikro dhe të vogla 1. Me përjashtim të pikës 3, të nenit 24, të këtij ligji, ky seksion nuk zbatohet: a) për ofruesit e platformave online që klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe mikrondërmarrje, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe, b) për ofruesit e platformave online që më parë kualifikoheshin në statusin e një ndërmarrje të vogël dhe mikrondërmarrje, gjatë 12 muajve pas humbjes së atij statusi, përveçse kur ato janë platforma online shumë të mëdha në përputhje me nenin 33, të këtij ligji.	F	

19.2	Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, ky seksion zbatohet për ofruesit e platformave online që janë përcaktuar si platforma shumë të mëdha online në përputhje me nenin 33, pavarësisht nëse ato kualifikohen si ndërmarrje mikro apo të vogla.	1	19.2	2.Pavaresisht nga përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, ky seksion zbatohet për ofruesit e platformave online që janë përcaktuar si platforma shumë të mëdha online në përputhje me nenin 33, pavarësisht nëse ato kualifikohen si ndërmarrje mikro apo të vogla.	F	
20.1	Neni 20 Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave Ofruesit e platformave online duhet t'u ofrojnë përfituesve të shërbimit, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur një njoftim, për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh pas vendimit të përmendur në këtë paragraf, akses në një sistem efektiv të brendshëm për trajtimin e ankesave që u mundëson atyre të paraqesin ankesa, elektronikisht dhe pa pagesë, kundër vendimit të marrë nga ofruesi i platformës online pas marrjes së një njoftimi ose kundër vendimeve të mëposhtme të marra nga ofruesi i platformës online me arsyetimin se informacioni i ofruar nga marrësit përbën përmbajtje të paligjshme ose është i papajtueshëm me termat dhe kushtet e tij:	1	20.1	Neni 20 Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave 1.Ofruesit e platformave online, u sigurojnë marrësve të shërbimit, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur një njoftim, për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh nga marrja e vendimit të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, akses në një sistem efektiv të brendshëm të trajtimit të ankesave, i cili u mundëson atyre të paraqesin ankesa në mënyrë elektronike dhe pa pagesë, kundër vendimit të marrë nga ofruesi i platformës online pas marrjes së një njoftimi, ose kundër vendimeve të mëposhtme të marra nga ofruesi i platformës online, mbi bazën se informacioni i ofruar nga marrësit e shërbimit përbën përmbajtje të paligjshme, ose është i papajtueshëm me termat dhe kushtet e tij:	F	
20.1. a	(a) vendimet nëse do të hiqet ose çaktivizohet qasja në informacion ose do të kufizohet dukshmëria e tij;	1	20.1. a	a) vendimet nëse do të hiqet, çaktivizohet aksesimi ose kufizohet paraqitja e informacionit;	F	
20.1. b	(b) vendimet nëse do të pezullohet ose ndërpritet ofrimi i shërbimit, tërësisht ose pjesërisht, për përfituesit;	1	20.1. b	b) vendimet nëse do të pezullohet, ose ndërpritet ofrimi i shërbimit tërësisht ose pjesërisht, për marrësit e shërbimit;	F	
20.1.c	(c) vendimet nëse do të pezullohet ose mbyllet llogaria e përfituesve;	1	20.1.c	c) vendimet nëse do të pezullohet, ose mbyllet llogaria e marrësve të shërbimit;	F	
20.1. d	(d) vendimet nëse do të pezullohet, ndërpritet ose kufizohet ndryshe aftësia për të monetizuar informacionin e dhënë nga marrësit.	1	20.1. ç	ç) vendimet nëse do të pezullohet, ndërpritet, ose kufizohet ndryshe aftësia për të gjeneruar të ardhura nga informacioni i ofruar nga marrësit e shërbimit.	F	
20.2	Periudha prej të paktën gjashtë muajsh e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni fillon ditën në të cilën marrësi i shërbimit informohet për vendimin në përputhje me nenin 16(5) ose nenin 17.	1	20.2	2.Periudha prej të paktën gjashtë muajsh e përmendur në pikën 1, të këtij neni, fillon në ditën në të cilën marrësi i shërbimit njoftohet për vendimin në përputhje me pikën 5, të nenit 16, të këtij ligji, ose me nenin 17, të këtij ligji.	F	
20.3	Ofruesit e platformave online duhet të sigurojnë që sistemet e tyre të brendshme të trajtimit të ankesave të jenë të lehta për t'u aksesuar, miqësore për përdoruesit dhe të mundësojnë e lehtësojnë paraqitjen e ankesave mjaftueshëm të sakta dhe të argumentuara në mënyrë adekuate.	1	20.3	3.Ofruesit e platformave online, sigurojnë që sistemet e tyre të brendshme të trajtimit të ankesave, të jenë lehtësisht të aksesueshme, miqësore për përdoruesin dhe të mundësojnë e lehtësojnë paraqitjen e ankesave	F	

	përmendet në nënparagrafin e parë, të jetë lehtësisht i arritshëm në ndërfaqen e tyre online, i qartë dhe miqësor për përdoruesit. Nënparagrafi i parë nuk cenon të drejtën e marrësit të shërbimit në fjalë për të filluar, në çdo fazë, procedurat për të kundërshtuar ato vendime nga ofruesit e platformave online para një gjykate në përputhje me ligjin në fuqi.			të jetë lehtësisht i aksesueshëm në ndërfaqen e tyre online, i qartë dhe miqësor për përdoruesin. Paragrafi i parë nuk çënon të drejtën e marrësit të shërbimit për të iniciuar, në çdo fazë, procedurë gjyqësore për kundërshtimin e këtyre vendimeve të ofruesve të platformave online, në përputhje me ligjin e zbatueshëm.		
21.2	Të dyja palët do të angazhohen, me mirëbesim, me organin e zgjedhur të certifikuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ofruesit e platformave online mund të refuzojnë të angazhohen me një organ të tillë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës nëse një mosmarrëveshje është zgjidhur tashmë në lidhje me të njëjtin informacion dhe të njëjtat arsye të paligjshmërisë ose papajtueshmërisë së supozuar të përmbajtjes. Organi i certifikuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës nuk do të ketë fuqinë për të imponuar një zgjidhje detyruese të mosmarrëveshjes mbi palët.	1	21.3	3. Të dyja palët angazhohen me mirëbesim në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes pranë organit të certifikuar të zgjidhjes jashtëgjyqësore, me qëllim zgjidhjen e saj. Ofruesit e platformave online refuzojnë të angazhohen me një organ të tillë, nëse një mosmarrëveshje e mëparshme është zgjidhur tashmë në lidhje me të njëjtin informacion dhe të njëjtat baza të pretenduara të paligjshmërisë ose papajtueshmërisë së përmbajtjes. Organi i certifikuar për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve nuk ka të drejtë të imponojë një zgjidhje të detyrueshme të mosmarrëveshjes mbi palët.	F	
21.3	Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale i Shtetit Anëtar ku është themeluar organi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës, për një periudhë maksimale prej pesë vitesh, e cila mund të rinovohet, certifikon organin, me kërkesë të tij, kur organi ka treguar se i plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:	1	21.4	4. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale certifikon organin/et për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, e cila mund të rinovohet, me kërkesën e tij, kur ai ka provuar se plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:	F	
21.3.a	(a) është i paanshëm dhe i pavarur, përfshirë edhe financiarisht të pavarur, nga ofruesit e platformave online dhe nga përfituesit e shërbimit të ofruar nga ofruesit e platformave online, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur njoftime;	1	21.4.a	a) është i paanshëm dhe i pavarur, edhe financiarisht, nga ofruesit e platformave online dhe nga marrësit e shërbimit të ofruar nga ofruesit e platformave online, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur njoftime;	F	
21.3.b	(b) ka ekspertizën e nevojshme në lidhje me çështjet që lindin në një ose më shumë fusha të veçanta të përmbajtjes së paligjshme, ose në lidhje me zbatimin dhe zbatimin e termave dhe kushteve të një ose më shumë llojeve të platformave online, duke i lejuar organit të kontribuojë në mënyrë efektive në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje;	1	21.4.b	b) ka ekspertizën e nevojshme në lidhje me çështjet që lindin në një ose më shumë fusha të veçanta të përmbajtjes së paligjshme, ose në lidhje me zbatimin dhe ekzekutimin e termave dhe kushteve të një ose më shumë llojeve të platformave online, duke i mundësuar organit të kontribuojë në mënyrë efektive në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;	F	

21.3.c	(c) anëtarët e saj shpërblehen në një mënyrë që nuk lidhet me rezultatin e procedurës;	1	21.4.c	c) anëtarët e tij shpërblehen në një mënyrë që nuk lidhet me rezultatin e procedurës/vendimin e marrë;	F	
21.3.d	(d) zgjidhja e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës që ofron është lehtësisht e arritshme, nëpërmjet teknologjisë së komunikimeve elektronike dhe ofron mundësinë për të filluar zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe për të paraqitur dokumentet mbështetëse të kërkuara në internet;	1	21.4.ç	ç) zgjidhja jashtëgjyqësore e mosmarrëveshjeve që ofrohet është lehtësisht e aksesueshme, përmes teknologjiave të komunikimit elektronik dhe mundëson fillimin e procedurës dhe dorëzimin e dokumenteve mbështetëse përkatëse online;	F	
21.3.e	(e) është i aftë të zgjidhë mosmarrëveshjet në një mënyrë të shpejtë, efikase dhe me kosto efektive dhe në të paktën njërën nga gjuhët zyrtare të institucioneve të Bashkimit;	1	21.4.d	d)është në gjendje të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë të shpejtë, efikase dhe me kosto të ulët;	F	
21.3.f	(f) zgjidhja e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës që ofron zhvillohet në përputhje me rregulla të qarta dhe të drejta procedurale, të cilat janë lehtësisht të arritshme për publikun dhe që përputhen me ligjin në fuqi, përfshirë këtë nen.	1	21.4.e	e) zgjidhja jashtëgjyqësore e mosmarrëveshjeve zhvillohet në përputhje me rregulla të qarta dhe të drejta procedurale që janë lehtësisht të aksesueshme dhe publike dhe që janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, përfshirë këtë nen.	F	
21.3, pg.8	Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale, kur është e aplikueshme, duhet të specifikojë në certifikatë:	1	21.5	5.Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, kur është e aplikueshme, specifikon në certifikatë:	F	
21.3, pg.8/a	(a) çështjet e veçanta me të cilat lidhet ekspertiza e organit, siç përmendet në pikën (b) të nënparagrafit të parë; dhe	1	21.5.a	a)çështjet e veçanta për të cilat lidhet ekspertiza e organit, siç parashikohet në shkronjën b, të pikës 4, të këtij neni,	F	
21.3, pg.8/b	(b) gjuha ose gjuhët zyrtare të institucioneve të Bashkimit në të cilat organi është i aftë të zgjidhë mosmarrëveshjet, siç përmendet në pikën (c) të nënparagrafit të parë.	1	21.5.b	b)gjuha e procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes është gjuha shqipe.	F	
21.4	Organet e çertifikuara të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore duhet t'i raportojnë Koordinatorit të Shërbimeve Dixhitale që i çertifiko i ato, në baza vjetore, mbi funksionimin e tyre, duke specifikuar të paktën numrin e mosmarrëveshjeve që kanë marrë, informacionin mbi rezultatet e këtyre mosmarrëveshjeve, kohën mesatare të marrë për zgjidhjen e tyre dhe çdo mangësi apo vështirësi të hasur. Ato do të japin informacione shtesë me kërkesë të atij Koordinatorit të Shërbimeve Dixhitale.	1	21.6	6.Organet e certifikuar të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, i raportojnë çdo vit Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale që i ka certifikuar, mbi funksionimin e tyre, duke specifikuar të paktën numrin e mosmarrëveshjeve të pranuar, informacion mbi rezultatet e këtyre mosmarrëveshjeve, kohën mesatare të zgjidhjes dhe çdo mangësi ose vështirësi të hasur. Ato japin informacion shtesë me kërkesë të Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.	F	
21.4, pg.2	Koordinatorët e Shërbimeve Dixhitale, çdo dy vjet, hartojnë një raport mbi funksionimin e organeve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës që ata certifikuan. Ky raport do të thotë në veçanti:	1	21.7	7.Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale, çdo dy vjet, hartojnë një raport mbi funksionimin e organeve të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve që kanë certifikuar. Ky raport në veçanti:	F	

21.4, pg.2/a	(a) listim i numrit te mosmarrëveshjeve që çdo organ i çertifikuar i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës ka marrë çdo vit;	1	21.7.a	a) liston numrin e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore që çdo organ i çertifikuar ka pranuar çdo vit;	F	
21.4, pg.2/b	b)tregojnë rezultatet e procedurave të sjella para këtyre organeve dhe kohën mesatare të marrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;	1	21.7.b	b) tregon rezultatet e procedurave dhe kohën mesatare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore;	F	
31.2	Ofruesit e platformave online që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontratat e distancës me tregtarët, duhet të sigurohen që ndërfaqja e saj online të jetë projektuar dhe organizuar në	1	31.3	3. Ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët sigurojnë që ndërfaqja e tyre online të jetë	F	

	një mënyrë që ajo u lejon tregtarëve të japin të paktën si më poshtë:			e projektuar dhe e organizuar në mënyrë të tillë që t'u mundësojë tregtarëve të japin të paktën sa vijon:		
31.2.a	(a) informacionin e nevojshëm për identifikimin e qartë dhe pa mëdyshje të produkteve ose shërbimeve të promovuara ose të ofruara për konsumatorët e vendosur në Bashkim nëpërmjet shërbimeve të ofruesve;	1	31.3.a	a) informacionin e nevojshëm për identifikimin e qartë dhe të padiskutueshëm të produkteve ose shërbimeve të promovuara, ose të ofruara për konsumatorët e vendosur në Republikën e Shqipërisë, përmes shërbimeve të ofruesve;	F	
31.2.b	b) çdo shenjë që identifikon tregtarin si marka tregtare, simboli ose logoja; dhe,	1	31.3.b	(b) çdo shenjë identifikuese të tregtarit, siç është marka tregtare, simboli ose logoja; dhe,	F	
31.2.c	c) Kur është e zbatueshme, informacioni në lidhje me etiketimin dhe shënimin në përputhje me rregullat e ligjit të zbatueshëm të BE-së për sigurinë e produkteve dhe respektimin e produktit.	1	31.3.c	c) kur është e aplikueshme, informacionin lidhur me etiketimin dhe shënjimin në përputhje me rregullat e zbatueshme të së drejtës së Bashkimit Evropian për sigurinë e produkteve dhe pajtueshmërinë e produkteve.	F	
31.3	Ofruesit e platformave online që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontratat në distancë me tregtarët duhet të bëjnë përpjekjet më të mira për të vlerësuar nëse tregtarët e tillë kanë dhënë informacionin e përmendur në paragrafët 1 dhe 2 përpara se t'i lejojnë ata të ofrojnë produktet apo shërbimet e tyre në këto platforma. Pas lejimit të tregtarit për të ofruar produkte ose shërbime në platformën e saj online që lejon konsumatorët për të lidhur kontratat distancë me tregtarët, ofruesi duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të kontrolluar rastësisht në çdo zyrtare, lirisht të arritshme dhe machine-readable online database ose ndërfaqe online nëse produktet apo shërbimet e ofruara janë identifikuar si të paligjshme.	1	31.4	4. Ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, vlerësojnë nëse këta tregtarë kanë dhënë informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përpara se t'u lejojnë atyre ofrimin e produkteve ose shërbimeve në këto platforma. Pasi tregtari lejohet për të ofruar produkte ose shërbime në platformën e tij online, që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, ofruesi bën përpjekje të arsyeshme për të verifikuar në mënyrë të rastësishme, në çdo bazë të dhënash zyrtare, të aksesueshme lirisht dhe të lexueshme nga makinat, ose në ndërfaqe online, nëse produktet, ose shërbimet e ofruara janë identifikuar si të paligjshme.	F	
32.1	Neni 32 E drejta për informim Kur një ofrues i një platforme online që lejon konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarët bëhet i vetëdijshëm, pavarësisht nga mjetet e përdorura, se një produkt apo shërbim i paligjshëm është ofruar nga një tregtar për konsumatorët e vendosur në Bashkim nëpërmjet shërbimeve të tij, ky ofrues informon, për aq sa	1	32.1	Neni 32 E drejta për informim 1. Kur një ofrues i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët merr dijeni, pavarësisht mjetit të përdorur, se një produkt ose shërbim i paligjshëm është ofruar nga një tregtar për konsumatorët e vendosur në Republikën e Shqipërisë	F	

	ka detajet e kontaktit të tyre, konsumatorët që kanë blerë produktin ose shërbimin e paligjshëm nëpërmjet shërbimeve të tij të mëposhtme:			përmes shërbimeve të tij, ai duhet të informojë, për atë që disponon të dhënat e tyre të kontaktit, konsumatorët që kanë blerë produktin, ose shërbimin e paligjshëm, përmes shërbimeve të tij, për sa vijon:		
32.1.a	a) fakti që produkti ose shërbimi është i paligjshëm;	1	32.1.a	a) faktin që produkti ose shërbimi është i paligjshëm;	F	
32.1.b	(b) identitetin e tregtarit dhe,	1	32.1.b	b) identitetin e tregtarit; dhe	F	
32.1.c	c) Çdo mjet i përshtatshëm për t'u ndrequr.	1	32.1.c	c) çdo mjet përkatës juridik që është i disponueshëm.		
	Detyrimi i përcaktuar në nënparagrafin e parë kufizohet në blerjet e produkteve ose shërbimeve të paligjshme të bëra brenda gjashtë muajve para momentit kur ofruesi u bë i vetëdijshëm për paligjshmërinë.	1	32.2	2. Detyrimi i përcaktuar në nënparagrafin e parë, kufizohet në blerjet e produkteve ose shërbimeve të paligjshme të kryera brenda gjashtë muajve, përpara momentit kur ofruesi ka marrë dijeni për paligjshmërinë.	F	
32.2	Kur, në situatën e përmendur në paragrafin 1, ofruesi i platformës online që lejon konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarët nuk ka detajet e kontaktit të të gjithë konsumatorëve të interesuar, ai ofrues duhet të vërë publikisht në dispozicion dhe lehtësisht të arritshëm në ndërfaqen e tij online informacionin në lidhje me produktin ose shërbimin e paligjshëm, identitetin e tregtarit dhe çdo mjet përkatës të ndreqjes.	1	32.3	3. Kur, në situatën e përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, ofruesi i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, nuk disponon të dhënat e kontaktit të të gjithë konsumatorëve të përfshirë, ai bën publikisht të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme në ndërfaqen e tij online, informacionin lidhur me produktin ose shërbimin e paligjshëm, identitetin e tregtarit dhe çdo mjet përkatës të ushtrimit të të drejtave.	F	
33.1	Neni 33 Platformat online shumë të mëdha dhe motorët e kërkimit online shumë të mëdhenj Ky Seksion zbatohet për platformat online dhe motorët e kërkimit online që kanë një numër të marrësve aktivë mesatarë mujorë të shërbimit në Bashkim të barabartë ose më të lartë se 45 milionë, dhe që janë përcaktuar si platforma shumë të mëdha online ose motorë kërkimi shumë të mëdhenj online sipas paragrafit 4.	1	33.1	Neni 33 Platformat online shumë të mëdha dhe motorët e kërkimit online shumë të mëdhenj 1. Ky seksion zbatohet për platformat online dhe motorët e kërkimit online që nga Komisioni Evropian janë përcaktuar si platforma online shumë të mëdha dhe motorë kërkimi online shumë të mëdhenj, pavarësisht numrit të marrësve aktivë të shërbimit në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të atyre që nuk ofrojnë shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë.	F	
33.2	Komisioni miraton aktet e deleguara në përputhje me nenin 87 për të rregulluar numrin e marrësve aktivë mesatarë mujorë të shërbimit në Bashkimin e përmendur në paragrafin 1, ku popullsia e Bashkimit rritet ose ulet të paktën me 5 % në raport me popullsinë e saj në vitin 2020 ose popullsinë e saj pas rregullimit me anë të një	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	

	akti të deleguar në vitin në të cilin është miratuar akti më i fundit i deleguar. Në një rast të tillë, ai do të rregullojë numrin në mënyrë që të korrespondojë me 10 % të popullsisë së Bashkimit në vitin në të cilin miraton aktin e deleguar, të rrumbullakosur ose poshtë për të lejuar që numri të shprehet në miliona.					
33.3	Komisioni mund të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 87, pasi konsultohet me Bordin, për të plotësuar dispozitat e kësaj Rregulloreje duke shtruar metodologjinë për llogaritjen e numrit të marrësve aktivë mesatarë mujorë të shërbimit në Bashkim, për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni dhe nenit 24,2), Duke siguruar që metodologjia të marrë parasysh zhvillimet e tregut dhe teknologjike.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
33.4	Komisioni, pasi të ketë konsultuar shtetin anëtar të themelimit ose pasi të ketë marrë parasysh informacionin e dhënë nga Koordinatori i Themelimit të Shërbimeve Dixhitale sipas nenit 24, paragraf 4, miraton një vendim që përcakton si një platformë online shumë të madhe ose një motor kërkimi online shumë të madh për qëllimet e kësaj Rregulloreje platformën online ose motorin e kërkimit online që ka një numër marrësish aktivë mesatarë mujorë të shërbimit të barabartë ose më të lartë se numri i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni. Komisioni merr vendimin e tij në bazë të të dhënave të raportuara nga ofruesi i platformës online ose të motorit të kërkimit online sipas nenit 24, paragraf 2), ose informacioneve të kërkuara sipas nenit 24, paragraf 3, ose çdo informacioni tjetër që disponon Komisioni. Dështimi nga ofruesi i platformës online ose i motorit të kërkimit online për t'iu përmbajtur nenit 24, paragraf 2, ose për t'iu përmbajtur kërkesës nga Koordinatori i Themelimit të Shërbimeve Dixhitale ose nga Komisioni sipas nenit 24, paragraf 3, nuk e pengon Komisionin të përcaktojë atë ofrues si ofrues të një platforme shumë të madhe online ose të një motori kërkimi online shumë të madh sipas këtij paragrafi. Kur Komisioni e bazon vendimin e tij në informacione të tjera në dispozicion të Komisionit sipas nënparagrafit të parë të këtij paragrafi ose në bazë të informacioneve shtesë të kërkuara në bazë të nenit 24, paragraf 3,	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	

	Komisioni i jep ofruesit të platformës online ose të motorit të kërkimit online të interesuar 10 ditë pune në të cilat të paraqesë pikëpamjet e tij mbi gjetjet paraprake të Komisionit dhe mbi synimin e tij për të caktuar platformën online ose Motori i kërkimit online si një platformë shumë e madhe online ose si një motor kërkimi online shumë i madh, respektivisht. Komisioni merr parasysh pikëpamjet e paraqitura nga ofruesi i interesuar. Dështimi i ofruesit të platformës online ose të motorit të kërkimit online të interesuar për të paraqitur pikëpamjet e tij sipas nënparagrafit të tretë nuk do ta pengojë Komisionin të përcaktojë atë platformë online ose atë motor kërkimi online si një platformë shumë të madhe online ose si një motor kërkimi shumë të madh online, respektivisht, bazuar në informacione të tjera që kanë në dispozicion.					
33.5	Komisioni ndërpret emërtimin nëse, gjatë një periudhe të pandërprerë prej një viti, platforma online ose motori i kërkimit online nuk ka një numër marrësish aktivë mesatarë mujorë të shërbimit të barabartë ose më të lartë se numri i përmendur në paragrafin 1.	1	33.3	3.Koordinatori i Shërbimeve Digjitale e heq ofruesin e platformës online ose të motorit të kërkimit online nga lista e platformave online shumë të mëdha ose motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj për Shqipërinë, sapo të hiqet përcaktimi i tij si VLOPSE në Evropë.	F	
33.6	Komisioni njofton vendimet e tij në bazë të paragrafëve 4 dhe 5, pa vonesa të tepërta, për ofruesin e platformës online ose të motorit të kërkimit online të interesuar, pranë Bordit dhe Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale të themelimit. Komisioni do të sigurojë që lista e platformave të caktuara shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online të publikohet në <i>Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian</i> dhe ta mbajë këtë listë të përditësuar. Detyrimet e përcaktuara në këtë Seksion zbatohen ose pushojnë së aplikuari për platformat shumë të mëdha online dhe motorët shumë të mëdhenj të kërkimit online të interesuar nga katër muaj pas njoftimit ndaj ofruesit të përmendur në nënparagrafin e parë.	1	33.2; 33.4;	2. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale publikon në faqen e tij të internetit, listën e platformave online shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, të përcaktuar nga Komisioni Evropian dhe e përditëson atë menjëherë sa herë që lista e Komisionit ndryshohet. 4.Koordinatori i Shërbimeve Digjitale njofton menjëherë, ofruesin përkatës të platformës online ose të motorit të kërkimit online, për përfshirjen e tij në listën e platformave online shumë të mëdha ose motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj për Shqipërinë, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni.	F	
34.1	Neni 34 Vlerësimi i rrezikut Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit	1	34.1	Neni 34 Vlerësimi i rrezikut 1. Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online	F	

	online duhet të identifikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë me zell çdo rrezik sistemik në Bashkim që vjen nga projektimi ose funksionimi i shërbimit të tyre dhe sistemeve të lidhura me të, duke përfshirë sistemet algoritmike, ose nga përdorimi i bërë i shërbimeve të tyre. Ata kryejnë vlerësimet e rrezikut deri në datën e aplikimit të përmendur në nenin 33, paragrafi 6, nënparagrafin e dytë, dhe të paktën një herë në vit më pas, dhe në çdo rast para vendosjes së funksionaliteteve që ka të ngjarë të kenë një ndikim kritik në rreziqet e identifikuar në përputhje me këtë nen. Ky vlerësim i rrezikut duhet të jetë specifik për shërbimet e tyre dhe në proporcion me rreziqet sistematike, duke marrë në konsideratë ashpërsinë dhe probabilitetin e tyre, dhe do të përfshijë rreziqet sistematike të mëposhtme:			shumë të mëdhenj, identifikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë me kujdes çdo rrezik të sistemeve në Republikën e Shqipërisë, që buron nga projektimi ose funksionimi i shërbimit të tyre dhe sistemeve të lidhura me të, përfshirë sistemet algoritmike, ose nga përdorimi i shërbimeve të tyre. Ata kryejnë vlerësimet e rrezikut deri në datën e vendosjes në Shqipëri dhe të paktën një herë në vit pas kësaj, si dhe, në çdo rast, përpara vendosjes në përdorim të funksionaliteteve që ka të ngjarë të kenë ndikim kritik mbi rreziqet e identifikuar në përputhje me këtë nen. Ky vlerësim rreziku duhet të jetë specifik për shërbimet e tyre dhe proporcional me rreziqet e sistemeve, duke marrë në konsideratë ashpërsinë dhe probabilitetin e tyre dhe duhet të përfshijë rreziqet e sistematike të mëposhtme:		
34.1.a	a) shpërndarjen e përmbajtjeve të paligjshme nëpërmjet shërbimeve të tyre;	1	34.1.a	a) shpërndarjen e përmbajtjes së paligjshme përmes shërbimeve të tyre;	F	
34.1.b	b) çdo efekt negativ faktik ose të parashikueshëm për ushtrimin e të drejtave themelore, në veçanti të drejtat themelore për dinjitetin e njeriut të parashikuara në nenin 1 të Kartës, për respektimin e jetës private dhe familjare të parashikuara në nenin 7 të Kartës, për mbrojtjen e të dhënave personale të parashikuara në nenin 8 të Kartës, për lirinë e shprehjes dhe të informacionit, duke përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medias, të përcaktuar në nenin 11 të Kartës, për mosdiskriminimin e parashikuar në nenin 21 të Kartës, për respektimin e të drejtave të fëmijës të parashikuara në nenin 24 të Kartës dhe për një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit të parashikuara në nenin 38 të Kartës;	1	34.1.b	b) çdo efekt negativ aktual ose të parashikueshëm mbi ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;	F	
34.1.c	c) çdo efekt negativ faktik ose të parashikueshëm në diskursin qytetar dhe proceset zgjedhore, dhe sigurinë publike;	1	34.1.c	c) çdo efekt negativ aktual ose të parashikueshëm mbi debatin qytetar dhe proceset zgjedhore, si dhe rendin publik;	F	
34.1.d	d) çdo efekt negativ faktik ose të parashikueshëm në lidhje me dhunën me bazë gjinore, mbrojtjen e shëndetit publik dhe të miturve dhe pasoja të rënda negative për mirëqenien fizike dhe mendore të personit.	1	34.1.d	d) çdo efekt negativ aktual ose të parashikueshëm në lidhje me dhunën me bazë gjinore, mbrojtjen e shëndetit publik dhe të miturve, si dhe pasoja serioze	F	

				negative për mirëqenien fizike dhe mendore të personit.		
Neni34(2)	Gjatë kryerjes së vlerësimeve të rrezikut, ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online duhet të marrin parasysh, në veçanti, nëse dhe si ndikojnë faktorët e mëposhtëm në ndonjë nga rreziqet sistemike të përmendura në paragrafin 1:	1	34.2	2. Gjatë kryerjes së vlerësimeve të rrezikut, ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, marrin në konsideratë, në veçanti, nëse dhe në ç'mënyrë ndonjë prej rreziqeve sistemike të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 ndikohet nga faktorët e mëposhtëm:	F	
34.2.a	(a) projektimin e sistemeve të tyre rekomanduese dhe të çdo sistemi tjetër algoritmik përkatës;	1	34.2.a	a) projektimi i sistemeve të tyre rekomanduese dhe çdo sistemi tjetër algoritmik përkatës;	F	
34.2.b	b)sistemet e tyre të moderimit të përmbajtjes;	1	34.2.b	b) sistemet e tyre të moderimit të përmbajtjes;	F	
34.2.c	c)kushtet dhe kushtet e zbatueshme dhe zbatimin e tyre;	1	34.2.c	c) termat dhe kushtet e përdorimit dhe garantimi i respektimit të tyre;	F	
34.2.d	d)sistemet për përzgjedhjen dhe paraqitjen e reklamave;	1	34.2.d	d) sistemet e tyre për përzgjedhjen dhe paraqitjen e reklamave;	F	
34.2.e	e)Praktikat e lidhura me të dhënat e ofruesit.	1	34.2.e	e) praktikat e ofruesit lidhur me të dhënat.	F	
	Vlerësimet gjithashtu do të analizojnë nëse dhe si rreziqet sipas paragrafit 1 ndikohen nga manipulimi i qëllimshëm i shërbimit të tyre, duke përfshirë përdorimin joautentik ose shfrytëzimin e automatizuar të shërbimit, si dhe amplifikimin dhe shpërndarjen potencialisht të shpejtë dhe të gjerë të përmbajtjes së paligjshme dhe të informacionit që është i papajtueshëm me kushtet dhe kushtet e tyre. Vlerësimi merr parasysh aspekte specifike rajonale ose gjuhësore, duke përfshirë edhe kur është specifike për një Shtet Anëtar.	1		Vlerësimet gjithashtu marrin në konsideratë nëse dhe në ç'mënyrë rreziqet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, të këtij neni, ndikohen nga manipulimi i qëllimshëm i shërbimit të tyre, përfshirë përdorimin joautentik ose shfrytëzimin e automatizuar të shërbimit, si dhe nga amplifikimi dhe shpërndarja potencialisht e shpejtë dhe e gjerë e përmbajtjes së paligjshme dhe informacionit të papajtueshëm me termat dhe kushtet. Në vlerësime duhet të merren parasysh edhe aspektet specifike rajonale ose gjuhësore.		
34.3	Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online duhet të ruajnë dokumentet mbështetëse të vlerësimeve të rrezikut për të paktën tre vjet pas kryerjes së vlerësimeve të rrezikut dhe, me kërkesë, t'ia komunikojnë ato Komisionit dhe Koordinatorit të Shërbimeve Dixhitale të themelimit.	1	34.3	3. Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, ruajnë dokumentacionin mbështetës të vlerësimeve të rrezikut, për të paktën tre vjet pas kryerjes së këtyre vlerësimeve dhe me kërkesë, ia paraqesin atë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.	F	
35.1	Neni 35	1	35.1	Neni 35	F	

	Zbutja e rreziqeve			Zbutja e rreziqeve		
	Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online duhet të vendosin masa të arsyeshme, proporcionale dhe efektive të zbutjes, të përshtatura sipas rreziqeve specifike sistematike të identifikuar sipas nenit 34, duke marrë në konsideratë veçanërisht ndikimet e këtyre masave mbi të drejtat themelore. Masa të tilla mund të përfshijnë, kur është e zbatueshme:			1. Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, marrin masa zbutëse të arsyeshme, proporcionale dhe efektive, të përshtatura sipas rreziqeve specifike sistematike të identifikuar në përputhje me nenin 34, të këtij ligji, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të këtyre masave mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Këto masa përfshijnë, kur është e përshtatshme:		
35.1.a	a)përshtatjen e dizajnit, veçorive apo funksionimit të shërbimeve të tyre, duke përfshirë ndërfaqet e tyre online;	1	35.1.a	a) përshtatjen e projektimit, karakteristikave ose funksionimit të shërbimeve të tyre, përfshirë ndërfaqet online;	F	
35.1.b	b)përshtatjen e kushteve dhe kushteve të tyre dhe zbatimin e tyre;	1	35.1.b	b) përshtatjen e termave dhe kushteve dhe garantimin e respektimit të tyre;	F	
35.1.c	c) përshtatja e proceseve të moderimit të përmbajtjes, duke përfshirë shpejtësinë dhe cilësinë e njoftimeve të përpunimit lidhur me lloje të veçanta të përmbajtjeve të paligjshme dhe, kur është e përshtatshme, heqjen e shpejtë të, ose çaktivizimin e aksesit në përmbajtjen e njoftuar, në veçanti në lidhje me gjuhën e urrëjtjes së paligjshme ose dhunën kibernetike, si dhe përshtatjen e çdo procesi vendimmarrës përkatës dhe burimeve të dedikuara për moderimin e përmbajtjes;	1	35.1.c	c) përshtatjen e proceseve të moderimit të përmbajtjes, përfshirë shpejtësinë dhe cilësinë e trajtimit të njoftimeve, lidhur me lloje specifike të përmbajtjes së paligjshme dhe kur është e përshtatshme, heqjen ose çaktivizimin e menjëhershëm të aksesit në përmbajtjen e njoftuar, veçanërisht në lidhje me gjuhën e urrëjtjes së paligjshme ose dhunën online, si dhe përshtatjen e proceseve përkatëse të vendimmarrjes dhe burimeve të dedikuara për moderimin e përmbajtjes;	F	
35.1.d	d) testimin dhe përshtatjen e sistemeve të tyre algoritmike, duke përfshirë sistemet e tyre rekomanduese;	1	35.1.d	d)testimin dhe përshtatjen e sistemeve algoritmike, përfshirë sistemet rekomanduese;	F	
35.1.e	(e) përshtatjen e sistemeve të tyre reklamuese dhe miratimin e masave të synuara që kanë për qëllim kufizimin ose rregullimin e paraqitjes së reklamave në bashkëpunim me shërbimin që ato ofrojnë;	1	35.1.e	e) përshtatjen e sistemeve të reklamimit dhe miratimin e masave specifike që synojnë kufizimin ose përshtatjen e paraqitjes së reklamave të lidhura me shërbimin që ato ofrojnë;	F	
35.1.f	(f) përforcimin e proceseve të brendshme, burimeve, testimit, dokumentacionit ose mbikëqyrjes së ndonjë prej veprimtarive të tyre në veçanti në lidhje me zbulimin e rrezikut sistematik;	1	35.1.f	f) forcimin e proceseve të tyre të brendshme, burimeve, kapaciteteve të testimit, dokumentacionit ose mbikëqyrjes së çdo veprimtarie të tyre, veçanërisht për sa i përket zbulimit të rreziqeve sistematike;	F	
35.1.g	(g) fillimin ose rregullimin e bashkëpunimit me flamurtarët e besuar në përputhje me nenin 22 dhe zbatimin e vendimeve të organeve të	1	35.1.g	g) fillimin ose përshtatjen e bashkëpunimit me sinjalizuesit e besuar në përputhje me nenin 22, të këtij ligji dhe zbatimin e vendimeve të organeve të zgjidhjes	F	

	zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës sipas nenit 21;			jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve sipas nenit 21, të këtij ligji;		
35.1.h	h)fillimin ose rregullimin e bashkëpunimit me ofruesit e tjerë të platformave online ose të motorëve të kërkimit online nëpërmjet kodeve të sjelljes dhe protokolleve të krizës të përmendura përkatësisht në nenet 45 dhe 48;	1	35.1.h	h) fillimin ose përshtatjen e bashkëpunimit me ofrues të tjerë të platformave online, ose motorëve të kërkimit online, përmes kodeve të sjelljes dhe protokolleve të krizës të përmendura respektivisht në nenet 45 dhe 48, të këtij ligji;	F	
35.1.i	i)marrjen e masave sensibilizuese dhe përshtatjen e ndërfaqes së tyre online në mënyrë që t'u japin marrësve të shërbimit më shumë informacion;	1	35.1.i	i) miratimin e masave ndërgjegjësuere dhe përshtatjen e ndërfaqeve online për të ofruar më shumë informacion për marrësit e shërbimit;	F	
35.1.j	j)marrjen e masave të synuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duke përfshirë verifikimin e moshës dhe mjetet e kontrollit prindëror, mjete që kanë për qëllim të ndihmojnë të miturit të sinjalizojnë abuzimin ose të marrin mbështetje, sipas nevojës;	1	35.1.j	j) miratimin e masave specifike për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, përfshirë mjetet e verifikimit të moshës dhe kontrollit prindëror, ose mjetet që ndihmojnë të miturit të raportojnë abuzimin ose të marrin mbështetje, sipas rastit;	F	
35.1.k	k)Sigurimi që një send informacioni, qoftë ai përbën një imazh, audio apo video të gjeneruar apo të manipuluar që ngjan në mënyrë të konsiderueshme me personat, objektet, vendet apo entitetet apo ngjarjet e tjera ekzistuese dhe i duket në mënyrë të rreme një personi të jetë autentik ose i vërtetë, dallohet nëpërmjet shenjave të shquara kur paraqiten në ndërfaqet e tyre online, dhe, përveç kësaj, duke ofruar një funksionalitet të lehtë për t'u përdorur që u mundëson marrësve të shërbimit të tregojnë informacione të tilla.	1	35.1.k	k) garantimin që informacioni, i cili mund të marrë formën e një imazhi të gjeneruar, edhe përmes proceseve të inteligjencës artificiale, ose të manipuluar, apo përmbytjes audio ose video të gjeneruar, përfshirë përmes proceseve të inteligjencës artificiale, ose të manipuluar, që ngjan në mënyrë thelbësore me persona, objekte, vende, subjekte ose ngjarje ekzistuese dhe që paraqitet në mënyrë të rreme si autentik ose i vërtetë, të mund të dallohet përmes shenjimeve të dukshme kur paraqitet në ndërfaqet e tyre online dhe për më tepër, të ofrohet një funksionalitet lehtësisht i përdorshëm që u mundëson marrësve të shërbimit të tregojnë një informacion të tillë.	F	
35.2	Bordi, në bashkëpunim me Komisionin, publikon raporte të plota, një herë në vit. Raportet duhet të përfshijnë:	1	35.2	2. Koordinatori Kombëtar i Shërbimeve Digjitale, publikon raporte gjithëpërfshirëse një herë në vit. Raportet përfshijnë sa vijon:	F	
35.2.a	a)identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve sistemike më të spikatura dhe më të përsëritura të raportuara nga ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online ose të identifikuar nëpërmjet burimeve të tjera të informacionit, në veçanti ato të parashikuara në përputhje me nenet 39, 40 dhe 42;	1	35.2.a	a) identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve sistemike më të rëndësishme dhe më të përsëritura të raportuara nga ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, ose të identifikuar përmes burimeve të tjera të informacionit,	F	

				veçanërisht ato të përcaktuara në përputhje me nenet 39, 40 dhe 42, të këtij ligji;		
35.2.b	b)Praktikat më të mira për ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online për të zbutur rreziqet sistematike të identifikuar.	1	35.2.b	b) praktikat më të mira për ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, për zbutjen e rreziqeve sistematike të identifikuar.	F	
	Këto raporte paraqesin rreziqe sistematike të prishura nga Shtetet Anëtare në të cilat ato kanë ndodhur dhe në Bashkimin në tërësi, sipas kërkesës.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
35.3	3. Komisioni, në bashkëpunim me Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale, mund të nxjerrë udhëzime mbi zbatimin e paragrafit 1 në lidhje me rreziqet specifike, në veçanti për të paraqitur praktikat më të mira dhe për të rekomanduar masat e mundshme, duke pasur parasysh pasojat e mundshme të masave mbi të drejtat themelore të parashikuara në Kartën e të gjitha palëve të përfshira. Gjatë përgatitjes së këtyre udhëzimeve, Komisioni organizon konsultime publike.	1	35.3	3. Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, i jepet e drejta të nxjerrë udhëzime mbi zbatimin e paragrafit 1, të këtij neni, në lidhje me rreziqe specifike, veçanërisht për të paraqitur praktikat më të mira dhe për të rekomanduar masa të mundshme, duke marrë parasysh në mënyrë të duhur pasojat e mundshme të masave mbi të drejtat e të gjitha palëve të përfshira. Gjatë hartimit të këtyre udhëzimeve, Koordinator i Shërbimeve Digjitale analizon legjislationin dhe praktikat e Bashkimit Evropian dhe organizon konsultime publike.	F	
36.1	Neni 36 Mekanizmi i reagimit ndaj krizave 1. Kur ndodh një krizë, Komisioni, duke vepruar sipas një rekomandimi të Bordit mund të miratojë një vendim, duke kërkuar që një ose më shumë ofrues të platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online të ndërmarrin një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme:	1	36.1	Neni 36 Mekanizmi i reagimit ndaj krizave 1. Në rast të një situatë krize, Koordinator i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të nxjerrë një vendim me anë të të cilit kërkon nga një ose më shumë ofrues të platformave online shumë të mëdha ose motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, të kryejnë një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme:	F	
36.1.a	a)të vlerësojë nëse, dhe nëse po, deri në ç'masë dhe si, funksionimi dhe përdorimi i shërbimeve të tyre kontribuojnë ndjeshëm në një kërcënim serioz siç përmendet në paragrafin 2, apo ka gjasa ta bëjnë këtë;	1	36.1.a	a) të vlerësojnë nëse ka, dhe në çfarë mase dhe në ç'mënyrë funksionimi dhe përdorimi i shërbimeve të tyre, kontribuon ose ka të ngjarë të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme, në një kërcënim serioz të përmendur në paragrafin 3, të këtij neni;	F	
36.1.b	b)të identifikojë dhe të zbatojë masa specifike, efektive dhe proporcionale, si çdo nga ato të	1	36.1.b	b) të identifikojnë dhe zbatojnë masa specifike, efektive dhe	F	

	parashikuara në nenin 35, paragrafhe 1 ose nenin 48, paragrafhe 2, për të parandaluar, eliminuar ose kufizuar çdo kontribut të tillë në kërcënimin serioz të identifikuar sipas pikës a) të këtij paragrafi;			proporcionale, siç janë ato të parashikuara në pikën 1, të nenit 35 të këtij ligji, ose sipas në pikën 2, të nenit 46 të këtij ligji, për të parandaluar, eliminuar ose kufizuar çdo kontribut të tillë ndaj kërcënimit serioz të identifikuar në përputhje me shkronjën a, të kësaj pike;		
36.1.c	c)Raportoni në Komision deri në një datë të caktuar ose në intervale të rregullta të përcaktuara në vendim, mbi vlerësimet e përmendura në germën a), mbi përmbajtjen e saktë, zbatimin dhe ndikimin kualitativ dhe sasior të masave specifike të marra sipas pikës (b) dhe për çdo çështje tjetër që lidhet me këto vlerësime apo ato masa, siç specifikohet në vendim.	1	36.1.c	c) t'i raportojnë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, brenda një afati të caktuar ose në intervale të rregullta të përcaktuara në vendim, mbi vlerësimet e përmendura në shkronjën a, të kësaj pike, mbi përmbajtjen e saktë, zbatimin dhe ndikimin cilësor dhe sasior të masave specifike të marra sipas shkronjës b, të kësaj pike, si dhe mbi çdo çështje tjetër që lidhet me këto vlerësime ose masa, sipas përcaktimeve të vendimit.	F	
36.1, pg. 2	Kur identifikon dhe aplikon masat sipas pikës b) të këtij paragrafi, ofruesi i shërbimit ose ofruesit e shërbimeve duhet të marrin parasysh rëndësinë e kërcënimit serioz të përmendur në paragrafin 2, të urgjencës së masave dhe të implikimeve faktike ose potenciale për të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të interesuara, Duke përfshirë dështimin e mundshëm të masave për respektimin e të drejtave themelore të parashikuara në Kartë.	1	36.1, pg. 2	Kur identifikon dhe zbaton masat sipas germës b), të pikës 1, të këtij neni, ofruesi i shërbimit merr në konsideratë si duhet seriozitetin e kërcënimit të përmendur në pikën 3, të këtij neni, urgjencën e masave dhe pasojat aktuale ose të mundshme, për të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të përfshira, përfshirë mundësinë që masat të mos respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.	F	
36.2	Për qëllim të këtij neni, një krizë duhet të konsiderohet të ketë ndodhur kur rrethanat e jashtëzakonshme çojnë në një kërcënim serioz për sigurinë publike ose shëndetin publik në Bashkim ose në pjesë të rëndësishme të tij.	1	36.2	2. Për qëllimet e këtij neni, konsiderohet se ekziston ose po ndodh një situatë krize, kur rrethana të jashtëzakonshme krijojnë një kërcënim serioz ndaj rendit publik, proceseve zgjedhore ose shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë.	F	
36.3	Kur merr vendimin e përmendur në paragrafin 1, Komisioni siguron plotësimin e të gjitha kërkesave të mëposhtme:	1	36.3	3. Në rastin e nxjerrjes së një vendimi të përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, Koordinator i Shërbimeve Digjitale siguron që të plotësohen në mënyrë kumulative kërkesat e mëposhtme:	F	
36.3.a	a)veprimet e kërkuara nga vendimi janë rreptësisht të nevojshme, të justifikuara dhe proporcionale, duke pasur parasysh në veçanti gravitetin e kërcënimit serioz të përmendur në paragrafin 2, urgjencën e masave dhe	1	36.3.a	a) veprimet e kërkuara nga vendimi të jenë rreptësisht të nevojshme, të justifikuara dhe proporcionale, duke marrë veçanërisht parasysh seriozitetin e kërcënimit të	F	

	implikimet faktike ose potenciale për të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të interesuara, përfshirë dështimin e mundshëm të masave për respektimin e të drejtave themelore të parashikuara në Kartë;			përmendur në paragrafët 2 dhe 3, të këtij neni, urgjencën e masave dhe pasojat aktuale ose të mundshme për të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të përfshira, përfshirë mundësinë që masat të mos respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;		
36.3.b	b)Vendimi përcakton një periudhë të arsyeshme brenda së cilës duhen marrë masa specifike të përmendura në paragrafin 1, pika (b), duke pasur parasysh, në veçanti, urgjencën e këtyre masave dhe kohën e nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e tyre;	1	36.3.b	b) vendimi të përcaktojë një afat të arsyeshëm brenda të cilit duhet të merren masat specifike të përmendura në shkronjën b, të paragrafit 1, të këtij neni, duke marrë parasysh, në veçanti, urgjencën e këtyre masave dhe kohën e nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e tyre;	F	
36.3.c	c)Veprimet e kërkuara nga vendimi kufizohen në një periudhë që nuk kalon tre muaj.	1	36.3.c	c) veprimet e kërkuara nga vendimi të kufizohen në një periudhë që nuk tejkalon tre muaj.	F	
36.4	Pas miratimit të vendimit të përmendur në paragrafin 1, Komisioni, pa vonesë të tepërt, ndërmerr hapat e mëposhtëm:	1	36.4	4. Në përputhje me vendimin e përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në mënyrë të menjëhershme, ndërmerr veprimet e mëposhtme:	F	
36.4.a	a)njoftoni vendimin ndaj ofruesit ose ofruesve të cilëve u drejtohet vendimi;	1	36.4.a	a) informon ofruesin për nxjerrjen e vendimit;	F	
36.4.b	b)ta bëjë vendimin publikisht në dispozicion; dhe	1	36.4.b	b) e bën vendimin të disponueshëm për publikun.	F	
36.4.c	c)Informojeni Bordin për vendimin, ftojani të paraqesë pikëpamjet e tij dhe mbajeni të informuar për çdo zhvillim të mëvonshëm që ka të bëjë me vendimin.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
36.5	Zgjedhja e masave specifike që do të merren në bazë të paragrafit 1, pika b), dhe në paragrafin 7, nënparagrafi i dytë, mbetet tek ofruesi ose ofruesit e trajtuar me vendim të Komisionit.	1	36.5	5. Përzgjedhja e masave specifike që do të miratohen në përputhje me shkronjën b, të paragrafit 1 dhe paragrafit 9, të këtij neni, mbetet në diskrecionin e ofruesit.	F	
36.6	Komisioni mund me nismën e vet ose me kërkesë të ofruesit, të angazhohet në një dialog me ofruesin për të përcaktuar nëse, duke pasur parasysh rrethanat specifike të ofruesit, masat e synuara apo të zbatuara të përmendura në paragrafin 1, pika b), janë efektive dhe proporcionale në arritjen e objektivave të ndjekura. Në veçanti, Komisioni siguron që masat e marra nga ofruesi i shërbimit sipas paragrafit 1, pika (b), të përmbushin kërkesat e përmendura në paragrafin 3, pikat (a) dhe (c).	1	36.6	6. Koordinator i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë, me iniciativën e vet ose me kërkesë të ofruesit, të zhvillojë dialog me ofruesin për të përcaktuar nëse, duke marrë parasysh rrethanat specifike të ofruesit, masat e parashikuara ose të zbatuara të përmendura në shkronjën b, të paragrafit 1, të këtij neni, janë efektive dhe proporcionale për arritjen e objektivave të synuara. Koordinator i Shërbimeve Digjitale siguron që masat e marra nga	F	

				ofruesi i shërbimit sipas shkronjës b, të paragrafit 1, të këtij neni, të përmbushin kërkesat e përmendura në shkronjat a, dhe c, të paragrafit 4, të këtij neni.		
36.7	Komisioni monitoron zbatimin e masave specifike të marra sipas vendimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni në bazë të raporteve të përmendura në pikën c) të këtij paragrafi dhe çdo informacioni tjetër përkatës, përfshirë informacionin që mund të kërkojë sipas nenit 40 ose 67, duke marrë parasysh evolucionin e krizës. Komisioni i raporton rregullisht Bordit për këtë monitorim, të paktën në baza mujore.	1	36.7	7. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale monitoron zbatimin e masave specifike të marra në përputhje me vendimin e përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, mbi bazën e raporteve të përmendura në shkronjën c, të atij paragrafi dhe çdo informacioni tjetër përkatës, përfshirë informacionin që mund të kërkojë në përputhje me nenin 40, të këtij ligji, duke marrë parasysh zhvillimin e situatës së krizës.	F	
	Kur Komisioni konsideron se masat specifike të synuara ose të zbatuara sipas paragrafit 1, pika (b), nuk janë efektive ose proporcionale, ajo mund, pasi të konsultohet me Bordin, të miratojë një vendim që i kërkon ofruesit të shqyrtojë identifikimin ose zbatimin e këtyre masave specifike.	1	36.8	8. Kur Koordinatori i Shërbimeve Digjitale konsideron se masat specifike të parashikuara ose të zbatuara sipas shkronjës b, të paragrafit 1, të këtij neni nuk janë efektive ose proporcionale, ai ka të drejtë të nxjerrë një vendim të ri, duke i kërkuar ofruesit të rishikojë masat specifike të identifikuar, ose mënyrën e zbatimit të tyre. Duke marrë parasysh zhvillimin e situatës së krizës, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të ndryshojë vendimin e përmendur në paragrafët 1 ose 9, të këtij neni duke:	F	
36.8	Kur është e përshtatshme duke pasur parasysh evolucionin e krizës, Komisioni, duke vepruar sipas rekomandimit të Bordit, mund të ndryshojë vendimin e përmendur në paragrafin 1 ose në paragrafin 7, nënparagrafin e dytë, nga:	1	36.8	8...Duke marrë parasysh zhvillimin e situatës së krizës, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të ndryshojë vendimin e përmendur në paragrafët 1 ose 9, të këtij neni duke	F	
36.8.a	a)revokimin e vendimit dhe, kur është e përshtatshme, duke kërkuar që platforma shumë e madhe online ose motori shumë i madh i kërkimit online të pushojë së zbatuari masat e identifikuar dhe të zbatuara sipas paragrafit 1, pika (b), ose paragrafit 7, nënparagrafi i dytë, në veçanti kur baza për masa të tilla nuk ekziston më;	1	36.8.a	a) revokuar aktin dhe kur është e aplikueshme, duke kërkuar nga platforma online shumë e madhe ose motori i kërkimit online shumë i madh, të ndalojë zbatimin e masave të identifikuar dhe të zbatuara sipas shkronjës b, të paragrafit 1, ose paragrafit 9, të këtij neni, veçanërisht kur arsyet për zbatimin e këtyre masave nuk ekzistojnë më;	F	
36.8.b	b)zgjatja e periudhës së përmendur në paragrafin 3, pika ç), me një periudhë jo më shumë se tre muaj;	1	36.8.b	b) zgjatur periudhën e përmendur në shkronjën c, të paragrafit 4, të këtij neni, për një periudhë që nuk tejkalon tre muaj;	F	

36.8.c	c) Duke marrë parasysh përvojën e fituar në zbatimin e masave, në veçanti dështimin e mundshëm të masave për respektimin e të drejtave themelore të parashikuara në Kartë.	1	36.8.c	c) duke marrë parasysh përvojën e fituar nga zbatimi i masave, në veçanti mundësinë që masat të mos respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.	F	
36.9	Kërkesat e paragrafëve 1 deri në 6 zbatohen për vendimin dhe për ndryshimin e tij të përmendur në këtë nen.	1	36.9	9. Kërkesat e paragrafëve 1 deri në 6, të këtij neni, zbatohen edhe për vendimin dhe ndryshimin e tij, të përmendur në këtë nen.		
36.10	Komisioni merr parasysh më së shumti rekomandimin e Bordit të lëshuar sipas këtij neni.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
36.11	Komisioni i raporton Parlamentit Evropian dhe Këshillit çdo vit pas miratimit të vendimeve në përputhje me këtë Nen dhe, në çdo rast, tre muaj pas përfundimit të krizës, mbi zbatimin e masave specifike të marra sipas këtyre vendimeve.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
37.1	Neni 37 Auditimi i pavarur Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online duhet t'u nënshtrohen, me shpenzimet e tyre dhe të paktën një herë në vit, auditimeve të pavarura për të vlerësuar përputhshmërinë me këto:	1	37.1	Neni 37 Auditimi i pavarur 1. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, i nënshtrohen, me shpenzimet e tyre dhe të paktën një herë në vit, auditimeve të pavarura për të vlerësuar përputhshmërinë me sa vijon:	F	
37.1.a	(a) detyrimet e përcaktuara në kapitullin III;	1	37.1.a	a) detyrimet e përcaktuara në Kreun III, të këtij ligji;	F	
37.1.b	b) çdo angazhim të ndërmarrë në përputhje me kodet e sjelljes të përmendura në nenet 45 dhe 46 dhe protokollet e krizës të përmendura në nenin 48.	1	37.1.b	b) çdo angazhim të ndërmarrë në kuadër të kodeve të sjelljes të përmendura në nenet 45, dhe 46, të këtij ligji, dhe protokollet e krizës të përmendura në nenin 48, të këtij ligji.	F	

37.2	2. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online duhet t'u lejojnë organizatave që kryejnë auditimet sipas këtij neni bashkëpunimin dhe ndihmën e nevojshme për t'u mundësuar atyre kryerjen e këtyre auditimeve në mënyrë efektive, efikase dhe në kohën e duhur, duke përfshirë duke u dhënë atyre akses në të gjitha të dhënat dhe lokalet përkatëse dhe duke iu përgjigjur pyetjeve me gojë ose me shkrim. Ata do të përmbahen nga pengimi, ndikimi i tepërt ose dëmtimi i performancës së kontrollit. Auditimet e tilla sigurojnë një nivel të përshtatshëm konfidencialiteti dhe fshehtësie profesionale në lidhje me informacionin e marrë nga ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online dhe palëve të treta në kontekstin e kontroleve, duke përfshirë pas përfundimit të kontroleve. Megjithatë, përmbushja e kësaj kërkesë nuk do të ndikojë negativisht në kryerjen e kontroleve dhe dispozitave të tjera të kësaj rregulloreje, në veçanti ato mbi transparencën, mbikëqyrjen dhe zbatimin. Kur është e nevojshme për qëllime të raportimit të transparencës në përputhje me nenin 42, paragrafi 4, raporti i auditit dhe raporti i zbatimit të auditit të përmendur në paragrafët 4 dhe 6 të këtij neni, shoqërohen me versione që nuk përmbajnë asnjë informacion që mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme konfidenciale.	1	37.2	2. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, u ofrojnë subjekteve që kryejnë auditimet sipas këtij neni, bashkëpunimin dhe asistencën e nevojshme për t'u mundësuar atyre kryerjen e këtyre auditimeve në mënyrë efektive, efikase dhe në kohë, duke u siguruar akses në të gjitha të dhënat dhe ambientet përkatëse, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtëpërdrejta ose me shkrim. Ata evitojnë pengimin, ndikimin e tepruar ose shmangjen e kryerjes së auditimit. Auditimet garantojnë një nivel të përshtatshëm konfidencialiteti dhe sekreti profesional në lidhje me informacionin e marrë nga ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, si dhe nga palët e treta, në kuadër të auditimeve, përfshirë edhe periudhën pas përfundimit të tyre. Përputhshmëria me këtë kërkesë, nuk cenon zhvillimin e auditimeve dhe dispozitat e tjera të këtij ligji, veçanërisht dispozitat mbi transparencën, mbikëqyrjen dhe zbatimin. Kur është e nevojshme për qëllime të raportimit të transparencës sipas paragrafit 4 të nenit 42, të këtij ligji, raporti i auditimit dhe raporti mbi zbatimin e masave pasuese të rekomanduara nga auditimi, të përmendura në paragrafët 5, dhe 7, të këtij neni, shoqërohen me versione që nuk përmbajnë informacion që mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme konfidencial.	F	
37.3	Auditimet e kryera sipas paragrafit 1 kryhen nga organizatat të cilat:	1	37.3	3. Auditimet e kryera sipas paragrafit 1, të këtij neni, kryhen nga organizata të cilat:	F	
37.3.a	(a) janë të pavarur nga, dhe nuk kanë ndonjë konflikt interesi me, ofruesin e platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online të interesuar dhe çdo person juridik të lidhur me atë ofrues; në veçanti:	1	37.3.a	a) janë të pavarura nga, dhe nuk kanë konflikt interesi me, ofruesin e platformës shumë të madhe online ose të motorit shumë të madh të kërkimit online në fjalë dhe çdo person tjetër juridik të lidhur me atë ofrues, në veçanti:	F	
37.3.a. (i)	(i) nuk kanë ofruar shërbime jo-audituese lidhur me çështjet e audituara tek ofruesi i platformës shumë të madhe online ose të motorit shumë të madh të kërkimit online të interesuar dhe me	1	37.3.a. (i)	i. nuk i kanë ofruar ofruesit të platformës shumë të madhe online ose motorit shumë të madh të kërkimit online në fjalë, ose ndonjë personi juridik të lidhur	F	

	ndonjë person juridik të lidhur me atë ofrues në periudhën 12 mujore para fillimit të kontrollit dhe janë angazhuar të mos u ofrojnë atyre shërbime të tilla në periudhën 12 mujore pas përfundimit të kontrollit;			me atë ofrues, shërbime të tjera pa lidhje me auditimin ose çështje të audituara gjatë 12 muajve para fillimit të auditimit dhe marrin përsipër të mos ofrojnë shërbime të tilla gjatë 12 muajve pas përfundimit të procesit të auditimit;		
37.3.a. (ii)	(ii) nuk kanë ofruar shërbime audituese sipas këtij Neni për ofruesin e platformës shumë të madhe online ose të motorit shumë të madh të kërkimit online të interesuar dhe çdo personi juridik të lidhur me atë ofrues gjatë një periudhe më të gjatë se 10 vjet rresht;	1	37.3.a. (ii)	ii. nuk kanë ofruar shërbime auditimi sipas këtij neni, për ofruesin e platformës shumë të madhe online ose motorit shumë të madh të kërkimit online në fjalë, ose për ndonjë person juridik të lidhur me atë ofrues për më shumë se 10 vite radhazi;	F	
37.3.a. (iii)	(iii) nuk janë duke kryer auditin në këmbim të tarifave të cilat janë në varësi të rezultatit të kontrollit;	1	37.3.a. (iii)	iii. nuk kryejnë auditimin kundrejt tarifave që varen nga rezultati i auditimit;	F	
37.3.b	b) kanë ekspertizë të provuar në fushën e menaxhimit të rrezikut, kompetencës teknike dhe aftësive;	1	37.3.b	b) kanë ekspertizë të provuar në menaxhimin e rrezikut, si dhe aftësi dhe kapacitete teknike;	F	
37.3.c	(c) kanë objektivitet të provuar dhe etikë profesionale, bazuar në veçanti në respektimin e kodeve të praktikës apo standardeve të përshtatshme.	1	37.3.c	c) kanë objektivitet dhe etikë profesionale të provuar, veçanërisht duke respektuar kode praktike ose standarde të përshtatshme.	F	
37.4	4. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online duhet të sigurohen që organizatat që kryejnë auditimet të krijojnë një raport auditimi për çdo auditim. Ky raport do të jetë i vërtetuar, me shkrim, dhe do të përfshijë të paktën këto:	1	37.4	4. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, sigurojnë që audituesit të hartojnë një raport auditimi për çdo auditim. Ky raport duhet të jetë i arsyetuar, i hartuar me shkrim dhe të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:	F	
43.2	Shuma e përgjithshme e tarifave vjetore të mbikëqyrjes mbulon kostot e vlerësuara që Komisioni kryen në lidhje me detyrat e tij mbikëqyrëse sipas kësaj Rregulloreje, në veçanti kostot që lidhen me emërtimin sipas nenit 33, për ngritjen, mirëmbajtjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave sipas nenit 24, paragrafe 5 dhe ndaj sistemit të ndarjes së informacionit sipas nenit 85, ndaj referimeve në bazë të nenit 59, mbështetjes së Bordit sipas nenit 62 dhe detyrave mbikëqyrëse sipas nenit 56 dhe seksionit 4 të kapitullit IV.	1	43.2	2. Shuma totale e tarifave mbikëqyrëse vjetore, mbulon kostot e vlerësuara që Koordinatori i Shërbimeve Digjitale përballon, në lidhje me detyrat e tij mbikëqyrëse sipas këtij ligji.	F	
43.3	Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, ngarkohen çdo vit një tarifë mbikëqyrëse për çdo shërbim për të cilin janë përcaktuar sipas nenit 33.	1	43.3	3. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online i nënshtrohen një tarife mbikëqyrëse vjetore për çdo shërbim të përcaktuar sipas nenit 33, të këtij ligji. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale	F	

	Komisioni miraton akte zbatuese që përcaktojnë shumën e tarifës vjetore të mbikëqyrjes në lidhje me çdo ofrues të platformës shumë të madhe online ose të motorit shumë të madh të kërkimit online. Kur miraton ato akte zbatuese, Komisioni zbaton metodologjinë e përcaktuar në aktin e deleguar të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni dhe respekton parimet e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni. Ato akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 88.			përcakton shumën e tarifave mbikëqyrëse vjetore për secilin ofrues të platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online për vitin pasardhës, në përputhje me metodologjinë e përmendur në paragrafin 4, të këtij neni.		
43.4	Komisioni miraton aktet e deleguara, në përputhje me nenin 87, duke parashtruar metodologjinë dhe procedurat e hollësishme për:	1	43.4	4. Koordinator i Shërbimeve Digjitale nxjerr, në përputhje me parimet e përcaktuara në paragrafin 5, të këtij neni, metodologjinë dhe procedurat e detajuara për:	F	
43.4.a	a)përcaktimin e kostove të vlerësuara të përmendura në paragrafin 2;	1	43.4.a	a) përcaktimin e kostove të vlerësuara të përmendura në paragrafin 2, të këtij neni;	F	
43.4.b	b)përcaktimin e tarifave mbikëqyrëse vjetore individuale të përmendura në paragrafin 5, pikat (b) dhe ç);	1	43.4.b	b)përcaktimin e tarifave individuale mbikëqyrëse vjetore, të përmendura në shkronjat “b” dhe “c” të paragrafit 5 të këtij neni;	F	
43.4.c	c)përcaktimin e limitit maksimal të përgjithshëm të përcaktuar në paragrafin 5, pika (c); dhe	1	43.4.c	c)përcaktimin e kufirit maksimal të përgjithshëm të përcaktuar në shkronjën “c”; të paragrafit 5, të këtij neni dhe	F	
43.4.d	d)Rregullimet e hollësishme të nevojshme për të bërë pagesat.	1	43.4.ç	ç)rregullat e detajuara të nevojshme për kryerjen e pagesave.	F	
	Gjatë miratimit të këtyre akteve të deleguara, Komisioni respekton parimet e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
43.5	5. Akti zbatues i përmendur në paragrafin 3 dhe akti i deleguar i përmendur në paragrafin 4, respekton parimet e mëposhtme:	1	43.5	5. Aktet e nxjerra sipas paragrafëve 3 dhe 4, të këtij neni respektojnë parimet e mëposhtme:	F	
43.5.a	a)Vlerësimi i shumës së përgjithshme të tarifës vjetore të mbikëqyrjes merr parasysh kostot e kryera në vitin paraardhës;	1	43.5.a	a) vlerësimi i shumës totale të tarifës mbikëqyrëse vjetore, merr në konsideratë kostot e përballuara gjatë vitit paraardhës;	F	
43.5.b	b)Tarifa vjetore mbikëqyrëse është në proporcion me numrin e marrësve aktivë	1	43.5.b	b) tarifa mbikëqyrëse vjetore është proporcionale me numrin mesatar	F	

	mujorë mesatarë në Bashkimin e çdo platforme shumë të madhe online ose çdo motori kërkimi online shumë të madh të përcaktuar sipas nenit 33;			mujor të marrësve aktivë të shërbimit në Republikën e Shqipërisë, të secilës platformë shumë të madhe online ose motori shumë të madh të kërkimit online, të përcaktuar sipas nenit 33, të këtij ligji;		
43.5.c	c)Shuma e përgjithshme e tarifës vjetore mbikëqyrëse të ngarkuar për një ofrues të caktuar të platformës shumë të madhe online ose motorit shumë të madh të kërkimit nuk i kalon, në çdo rast, 0,05 % të të ardhurave neto vjetore botërore në vitin financiar paraardhës.	1	43.5.c	c) shuma totale e tarifës mbikëqyrëse vjetore e vendosur ndaj një ofruesi të caktuar të një platforme shumë të madhe online, ose motori shumë të madh të kërkimit online, nuk tejkalon në asnjë rast 0.5% të të ardhurave të tij neto vjetore nga ofrimi i shërbimeve të ofruara në territorin kombëtar gjatë vitit financiar paraardhës.	F	
43.6	Tarifat individuale vjetore të mbikëqyrjes të ngarkuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, përbëjnë të ardhura të jashtme të caktuara në përputhje me nenin 21,5) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ⁽⁴¹⁾ .	1	43.6	6. Tarifat individuale mbikëqyrëse vjetore të vendosura sipas paragrafit 1, të këtij neni, transferohen në buxhetin e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.		
43.7	Komisioni raporton çdo vit në Parlamentin Evropian dhe në Këshill mbi shumën e përgjithshme të kostove të kryera për përmbushjen e detyrave sipas kësaj Rregulloreje dhe shumën totale të tarifave individuale vjetore mbikëqyrëse të ngarkuara në vitin paraardhës.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
44.1	Neni 44 Standardet Komisioni konsultohet me Bordin dhe mbështet dhe nxit zhvillimin dhe zbatimin e standardeve vullnetare të përcaktuara nga organet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, të paktën në lidhje me këto:	1	44.1	SEKSIONI 6 DISPOZITA TË TJERA LIDHUR ME DETYRIMET E DUE DILIGENCE Neni 44 Standardet 1.Koordinatori i Shërbimeve Digjitale mbështet dhe promovon zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të përcaktuara nga organet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, të paktën në lidhje me sa vijon:	F	
44.1.a	dërgimin elektronik të njoftimeve sipas nenit 16;	1	44.1.a	a) paraqitjen elektronike të njoftimeve sipas nenit 16, të këtij ligji;	F	

44.1.b	templates, design and process standards for communicating with the recipients of the service in a user-friendly manner on restrictions resulting from terms and conditions and changes thereto;	1	44.1.b	b)modelet, standardet e projektimit dhe procesit për komunikimin me marrësit e shërbimit në një mënyrë lehtësisht të përdorshme, lidhur me kufizimet që rrjedhin nga kushtet dhe afatet, si dhe ndryshimet e tyre;	F	
44.1.c	dërgimin elektronik të njoftimeve nga flamurtarët e besuar sipas nenit 22, duke përfshirë nëpërmjet ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve;	1	44.1.c	c) paraqitjen elektronike të njoftimeve nga sinjalizuesit e besuar sipas nenit 22, të këtij ligji, duke përfshirë përmes ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API);	F	
4.1.d	ndërfaqe specifike, duke përfshirë ndërfaqet e programimit të aplikacioneve, për të lehtësuar respektimin e detyrimeve të përcaktuara në nenet 39 dhe 40;	1	4.1.d	d)ndërfaqe specifike, përfshirë ndërfaqet e programimit të aplikacioneve (API), për të lehtësuar përputhshmërinë me detyrimet e përcaktuara në nenet 39 dhe 40, të këtij ligji;	F	
44.1.e	auditim të platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online sipas nenit 37;	1	44.1.e	e)auditimin e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online sipas nenit 37, të këtij ligji;	F	
44.1.f	ndërveprueshmërinë e depove të reklamave të përmendura në nenin 39, paragraphe 2);	1	44.1.f	f)interoperabilitetin e regjistrave të reklamave të përmendura në paragrafin 2 të nenit 39, të këtij ligji;	F	
44.1.g	transmetimin e të dhënave ndërmjet ndërmjetësve të reklamave në mbështetje të detyrimeve të transparencës sipas nenit 26, paragraphe 1, pikat (b), ç) dhe (d);	1	44.1.g	g)transmetimin e të dhënave ndërmjet ndërmjetësve të reklamimit në mbështetje të detyrimeve të transparencës sipas paragrafit 1, shkronjat “b”, “c” dhe “d” të nenit 26, të këtij ligji;	F	
44.1.h	masat teknike për të mundësuar respektimin e detyrimeve në lidhje me reklamat që përmban kjo rregullore, duke përfshirë detyrimet në lidhje me shenjat e shquara për reklamat dhe komunikimet tregtare të përmendura në nenin 26;	1	44.1.h	h)masat teknike për të mundësuar përputhshmërinë me detyrimet lidhur me reklamimin të përfshira në këtë rregullore, përfshirë detyrimet lidhur me shenjat dalluese për reklamat dhe komunikimet tregtare të përmendura në nenin 26, të këtij ligji;	F	
44.1.i	ndërfaqet e zgjedhjes dhe paraqitjen e informacionit mbi parametrat kryesorë të llojeve të ndryshme të sistemeve rekomanduese, në përputhje me nenet 27 dhe 38;	1	44.1.i	i)ndërfaqet e zgjedhjes dhe paraqitjen e informacionit mbi parametrat kryesorë të llojeve të ndryshme të sistemeve rekomanduese, në përputhje me nenet 27 dhe 38, të këtij ligji;	F	
44.1.j	Standardet për masat e synuara për mbrojtjen e të miturve online.	1	44.1.j	j)standardet për masa me synim mbrojtjen e të miturve online.	F	
44.2	Komisioni mbështet azhornimin e standardeve në dritën e zhvillimeve teknologjike dhe sjelljen e marrësve të shërbimeve në fjalë. Informacioni përkatës në lidhje me përditësimin e standardeve do të jetë i disponueshëm publikisht dhe lehtësisht i arritshëm.	1	44.2	2. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, mbështet përditësimin e standardeve, në funksion të zhvillimeve teknologjike dhe sjelljes së marrësve të shërbimeve në fjalë. Informacioni përkatës mbi përditësimin e	F	

				standardeve bëhet publikisht i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm.		
45.1	Neni 45 Kodet e sjelljes 1. Komisioni dhe Bordi inkurajojnë dhe lehtësojnë hartimin e kodeve vullnetare të sjelljes në nivel të Bashkimit për të kontribuar në zbatimin e duhur të kësaj rregulloreje, duke marrë parasysh në veçanti sfidat specifike të trajtimit të llojeve të ndryshme të përmbajtjes së paligjshme dhe rreziqeve sistematike, në përputhje me ligjin e Bashkimit në veçanti për konkurrencën dhe mbrojtjen e të dhënave personale.	1	45.1	Neni 45 Kodet e sjelljes 1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, mbështet dhe lehtëson zhvillimin e kodeve vullnetare të sjelljes për të kontribuar në zbatimin e duhur të këtij ligji, duke marrë në konsideratë në veçanti sfidat specifike që rrjedhin nga lloje të ndryshme të përmbajtjes së paligjshme dhe rreziqeve sistematike, veçanërisht në lidhje me konkurrencën dhe mbrojtjen e të dhënave personale.	F	
45.2	2. Kur dalin rreziqe të rëndësishme sistematike brenda kuptimit të nenit 34, paragrafi 1 dhe kanë të bëjnë me disa platforma shumë të mëdha online ose motorë kërkimi shumë të mëdhenj online, Komisioni mund të ftojë ofruesit e platformave shumë të mëdha online të interesuara ose ofruesit e motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online të interesuar, dhe ofruesit e tjerë të platformave shumë të mëdha online, të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, të platformave online dhe të shërbimeve të tjera ndërmjetëse, sipas nevojës, si dhe autoriteteve kompetente përkatëse, organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të tjera relevante, për të marrë pjesë në hartimin e kodeve të sjelljes, duke përfshirë duke përcaktuar angazhimet për të marrë masa specifike për zbutjen e rrezikut, si dhe një kuadër të rregullt raportimi mbi çdo masë të marrë dhe rezultatet e tyre.	1	45.2	2. Kur lind një rrezik sistematik i konsiderueshëm në kuptim të paragrafit 1, të nenit 34, të këtij ligji, që prek disa platforma shumë të mëdha online, ose motorë shumë të mëdhenj të kërkimit online, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, fton ofruesit e platformave online në fjalë, ose ofruesit e motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online dhe ofrues të tjerë të platformave shumë të mëdha online, motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, platformave online dhe shërbimeve të tjera ndërmjetëse, sipas rastit, si dhe autoritetet kompetente përkatëse, organizatat e shoqërisë civile dhe palë të tjera të interesuara, të marrin pjesë në hartimin e kodeve të sjelljes, duke përfshirë përcaktimin e angazhimeve për ndërmarrjen e masave specifike për zbutjen e rrezikut, si dhe një kuadër të rregullt raportimi mbi çdo masë të marrë dhe rezultatet e tyre.	F	
45.3	Kur u japin efekt paragrafëve 1 dhe 2, Komisioni dhe Bordi, dhe kur organet e tjera përkatëse, synojnë të sigurojnë që kodet e sjelljes të përcaktojnë qartë objektivat e tyre specifike, të përmbajnë treguesit kryesorë të performancës për të matur arritjen e këtyre objektiveve dhe për të marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të interesuara,	1	45.3	3. Gjatë zbatimit të paragrafit 1, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe kur është e nevojshme, me organe të tjera, siguron që kodet e sjelljes të përcaktojnë qartë objektivat e tyre specifike, të përmbajnë tregues kyç të performancës për matjen e arritjes së	F	

	dhe në veçanti qytetarët, në nivel Bashkimi. Komisioni dhe Bordi synojnë gjithashtu të sigurojnë që pjesëmarrësit të raportojnë rregullisht pranë Komisionit dhe koordinatorëve të tyre përkatës të Shërbimeve Dixhitale të themelimit mbi çdo masë të marrë dhe rezultatet e tyre, siç maten me treguesit kryesorë të performancës që ato përmbajnë. Treguesit kryesorë të performancës dhe angazhimet e raportimit duhet të marrin parasysh dallimet në madhësi dhe kapacitetet midis pjesëmarrësve të ndryshëm.			këtyre objektivave dhe të marrin në konsideratë nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të interesuara, veçanërisht të qytetarëve. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, synon gjithashtu të sigurojë që pjesëmarrësit t'u raportojnë rregullisht Koordinatorëve të tyre të Shërbimeve Digjitale të vendit të themelimit, mbi çdo masë të marrë dhe rezultatet e tyre, të matura kundrejt treguesve kyç të performancës që ato përmbajnë. Treguesit kyç të performancës dhe angazhimet e raportimit, marrin në konsideratë ndryshimet në madhësi dhe kapacitetet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm.		
45.4	Komisioni dhe Bordi duhet të vlerësojnë nëse kodet e sjelljes përmbushin qëllimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 3 dhe duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë rregullisht arritjen e objektivave të tyre, duke pasur parasysh treguesit kryesorë të performancës që ato mund të përmbajnë. Ata do të publikojnë përfundimet e tyre. Komisioni dhe Bordi gjithashtu inkurajojnë dhe lehtësojnë shqyrtimin dhe përshtatjen e rregullt të kodeve të sjelljes. Në rastin e mosrespektimit sistematik të kodeve të sjelljes, Komisioni dhe Bordi mund t'i ftojnë nënshkruesit në kodet e sjelljes që të ndërmarrin veprimin e nevojshëm.	1	45.4	4. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, vlerëson nëse kodet e sjelljes përmbushin qëllimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 3, të këtij neni, si dhe monitoron dhe vlerëson rregullisht arritjen e objektivave të tyre, duke marrë në konsideratë treguesit kyç të performancës që ato mund të përmbajnë. Ai publikon konkluzionet e tij. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, inkurajon dhe lehtëson rishikimin dhe përshtatjen e rregullt të kodeve të sjelljes. Në rast të mosrespektimit sistematik të kodeve të sjelljes, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, fton nënshkruesit e kodeve të sjelljes të ndërmarrin veprimet e nevojshme.	F	
46.1	Neni 46 Kodet e sjelljes për reklamat online Komisioni inkurajon dhe lehtëson hartimin e kodeve vullnetare të sjelljes në nivel Bashkimi nga ofruesit e platformave online dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve përkatëse, si ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse të reklamave online, aktorë të tjerë të përfshirë në zinxhirin programor të vlerës së reklamave, ose organizatat që përfaqësojnë marrësit e shërbimit dhe organizatave të shoqërisë civile ose autoritetet përkatëse për të kontribuar në	1	46.1	Neni 46 Kodet e sjelljes për reklamat online 1. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, inkurajon dhe lehtëson hartimin e kodeve vullnetare të sjelljes nga ofruesit e platformave online dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve përkatëse, siç janë ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse të reklamimit online, aktorë të tjerë të përfshirë në zinxhirin e vlerës së reklamimit programatik, si dhe organizata që	F	

	transparencën e mëtjeshme për aktorët në reklamën online Zinxhiri i vlerës përtej kërkesave të neneve 26 dhe 39.			përfaqësojnë marrësit e shërbimit, organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet përkatëse, me qëllim rritjen e mëtjeshme të transparencës për aktorët në zinxhirin e vlerës së reklamimit online, përtej kërkesave të neneve 26 dhe 39, të këtij ligji.		
46.2	Komisioni synon të sigurojë që kodet e sjelljes të ndjekin një transmetim efektiv të informacionit që respekton plotësisht të drejtat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira, si dhe një mjedis konkurrues, transparent dhe të drejtë në reklamën online, në përputhje me Bashkimin dhe ligjin kombëtar, në veçanti mbi konkurrencën dhe mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale. Komisioni ka për qëllim të sigurojë që kodet e sjelljes të paktën të trajtojnë këto:	1	46.2	2. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, siguron që kodet e sjelljes të garantojnë një transmetim efektiv të informacionit që respekton plotësisht të drejtat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira, si dhe një mjedis konkurrues, transparent dhe të drejtë në reklamimin online, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe atë kombëtar, veçanërisht në fushën e konkurrencës dhe mbrojtjes së privatësisë dhe të të dhënave personale. Koordinator i Shërbimeve Digjitale synon gjithashtu që kodet e sjelljes të adresojnë të paktën sa vijon:	F	
46.2.a	a)transmetimin e informacionit të mbajtur nga ofruesit e ndërmjetësve të reklamave online tek marrësit e shërbimit në lidhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 26, paragraf 1, pikat b), ç) dhe d);	1	46.2.a	a) transmetimin e informacionit të mbajtur nga ofruesit e ndërmjetësimit të reklamimit online të marrësit e shërbimit, në lidhje me kërkesat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d”, paragrafi 1, neni 26, i këtij ligji.	F	
46.2.b	b)transmetimin e informacionit të mbajtur nga ofruesit e ndërmjetësve të reklamave online në depo sipas nenit 39;	1	46.2.b	b) transmetimin e informacionit të mbajtur nga ofruesit e ndërmjetësimit të reklamimit online drejt regjistrave sipas nenit 39, të këtij ligji;	F	
46.2.c	c)Informacion kuptimplotë mbi monetizimin e të dhënave.	1	46.2.c	c) informacion domethënës mbi monetizimin e të dhënave.	F	
46.3	Komisioni inkurajon zhvillimin e kodeve të sjelljes deri më 18 shkurt 2025 dhe aplikimin e tyre deri më 18 gusht 2025.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
46.4	Komisioni inkurajon të gjithë aktorët në zinxhirin e vlerës së reklamave online të përmendur në paragrafin 1 të miratojnë angazhimet e deklaruara në kodet e sjelljes dhe të respektojnë ato.	1	46.4	Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, inkurajon të gjithë aktorët në zinxhirin e vlerës së reklamimit online të përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, që të miratojnë	F	

				angazhimet e përcaktuara në kodet e sjelljes dhe t'i zbatojnë ato.		
47.1	Neni 47 Kodet e sjelljes për aksesueshmërinë Komisioni inkurajon dhe lehtëson hartimin e kodeve të sjelljes në nivel Bashkimi, me përfshirjen e ofruesve të platformave online dhe ofruesve të tjerë përkatës të shërbimeve, organizatave që përfaqësojnë marrësit e shërbimit dhe organizatave të shoqërisë civile ose autoriteteve përkatëse për të nxitur pjesëmarrjen e plotë dhe efektive, të barabartë, duke përmirësuar aksesin në shërbimet online që, Nëpërmjet dizajnit fillestar ose përshtatjes së mëvonshme, adresoni nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara.	1	47.1	Neni 47 Kodet e sjelljes për aksesueshmërinë 1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, inkurajon dhe lehtëson hartimin e kodeve të sjelljes, me pjesëmarrjen e ofruesve të platformave online dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve përkatëse, organizatave që përfaqësojnë marrësit e shërbimit, organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve përkatëse, me qëllim promovimin e pjesëmarrjes së plotë, efektive dhe të barabartë, përmes përmirësimit të aksesit në shërbimet online të cilat, përmes projektimit fillestar ose përshtatjes së mëvonshme, adresojnë nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara.	F	
47.2	Komisioni ka për qëllim të sigurojë që kodet e sjelljes të ndjekin objektivin për të siguruar që këto shërbime të jenë të arritshme në përputhje me Bashkimin dhe ligjin kombëtar, në mënyrë që të maksimizojnë përdorimin e tyre të parashikueshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Komisioni synon të sigurojë që kodet e sjelljes të adresojnë të paktën objektivat e mëposhtme:	1	47.2	2. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, synon që kodet e sjelljes të kenë objektiv garantimin e aksesueshmërisë së shërbimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar, me qëllim maksimizimin e përdorimit të tyre të nga personat me aftësi të kufizuara. Koordinator i Shërbimeve Digjitale synon që kodet e sjelljes të adresojnë të paktën objektivat e mëposhtme:	F	
47.2.a	a)projektimin dhe përshtatjen e shërbimeve për t'i bërë ato të arritshme për personat me aftësi të kufizuara duke i bërë ato të perceptueshme, operable, të kuptueshme dhe robuste;	1	47.2.a	a) projektimin dhe përshtatjen e shërbimeve për t'i bërë ato të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, duke i bërë ato të perceptueshme, të përdorshme, të kuptueshme dhe të qëndrueshme;	F	
47.2.b	b)shpjegimin e mënyrës se si shërbimet përmbushin kërkesat e zbatueshme të arritshmërisë dhe vënien e këtij informacioni në dispozicion të publikut në mënyrë të arritshme për personat me aftësi të kufizuara;	1	47.2.b	b)shpjegimin e mënyrës se si shërbimet përmbushin kërkesat e zbatueshme të aksesueshmërisë dhe vënien në dispozicion të këtij informacioni për publikun në një formë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;	F	

47.2.c	c)Vënia në dispozicion e informacionit, formularëve dhe masave të parashikuara në bazë të kësaj rregulloreje në mënyrë të tillë që ato të jenë të lehta për t'u gjetur, të lehta për t'u kuptuar dhe të arritshme për personat me aftësi të kufizuara.	1	47.2.c	c)vënien në dispozicion të informacionit, formularëve dhe masave të parashikuara sipas këtij ligji, në një mënyrë që ato të jenë lehtësisht të gjetshme, të kuptueshme dhe të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.	F	
47.3	Komisioni inkurajon zhvillimin e kodeve të sjelljes deri më 18 shkurt 2025 dhe aplikimin e tyre deri më 18 gusht 2025.	1	N.a	N.a	Jo e aplikueshme	
48.1	Neni 48 Protokollet e krizës Bordi mund të rekomandojë që Komisioni të nisë hartimin, në përputhje me paragrafët 2, 3 dhe 4, të protokolleve vullnetare të krizës për trajtimin e situatave të krizës. Këto situata do të kufizohen rreptësisht në rrethana të jashtëzakonshme që prekin sigurinë publike ose shëndetin publik.	1	48.1	Neni 48 Protokollet e krizës 1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale nxit hartimin, në përputhje me paragrafët 2, 3 dhe 4, të këtij neni, të protokolleve vullnetare të krizës për trajtimin e situatave të krizës. Këto situata kufizohen rreptësisht në rrethana të jashtëzakonshme që prekin sigurinë publike ose shëndetin publik.	F	
48.2	2. Komisioni inkurajon dhe lehtëson ofruesit e platformave shumë të mëdha online, të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online dhe, kur është e përshtatshme, ofruesit e platformave të tjera online ose të motorëve të tjerë të kërkimit online, për të marrë pjesë në hartimin, testimin dhe aplikimin e këtyre protokolleve të krizës. Komisioni synon të sigurojë që këto protokolle të krizës të përfshijnë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:	1	48.2	2. Koordinator i Shërbimeve Digjitale mbështet dhe lehtëson pjesëmarrjen e ofruesve të platformave online, ose motorëve online të kërkimit në zhvillimin, testimin dhe zbatimin e këtyre protokolleve të krizës. Protokollet e krizës përfshijnë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:	F	
48.2.a	a) duke shfaqur në mënyrë të dukshme informacion mbi situatën e krizës të ofruar nga autoritetet e Shteteve Anëtare ose në nivel Bashkimi, ose, në varësi të kontekstit të krizës, nga organe të tjera përkatëse të besueshme;	1	48.2.a	a)paraqitjen e informacionit mbi situatën e krizës, të ofruar nga autoritetet publike ose, sipas kontekstit të krizës, nga entitete të tjera përkatëse;	F	
48.2.b	b)duke siguruar që ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse të caktojë një pikë të caktuar kontakti për menaxhimin e krizave; kur është e rëndësishme, kjo mund të jetë pika elektronike e kontaktit e përmendur në nenin 11 ose, në rastin e ofruesve të platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, zyrtari i përputhshmërisë i përmendur në nenin 41;	1	48.2.b	b)sigurimin që ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse cakton një pikë kontakti specifike për menaxhimin e krizës; kur është e zbatueshme, kjo mund të jetë pika elektronike e kontaktit e përmendur në nenin 11, ndërsa në rastin e ofruesve të platformave shumë të mëdha online, ose motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online mund të jetë edhe zyrtari i përputhshmërisë i përmendur në nenin 41, të këtij ligji;	F	

48.2.c	c)kur është e zbatueshme, përshtati burimet e dedikuara për respektimin e detyrimeve të përcaktuara në nenet 16, 20, 22, 23 dhe 35 ndaj nevojave që dalin nga situata e krizës.	1	48.2.c	c)kur është e përshtatshme, përshtatjen e burimeve të dedikuara për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenet 16, 20, 22, 23 dhe 35, të këtij ligji, sipas nevojave që lindin nga situata e krizës.	F	
48.3	Komisioni, sipas nevojës, përfshin autoritetet e Shteteve Anëtare dhe mund të përfshijë gjithashtu organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit në hartimin, testimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të protokolleve të krizës. Komisioni, kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, mund të përfshijë edhe organizata të shoqërisë civile ose organizata të tjera përkatëse në hartimin e protokolleve të krizës.	1	48.3	3. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, sipas rastit, përfshin edhe autoritete të tjera, organe, zyra dhe agjenci në hartimin, testimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të protokolleve të krizës. Ai mund të përfshijë kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, organizata të shoqërisë civile, ose organizata të tjera përkatëse në hartimin e protokolleve të krizës.	F	
48.4	Komisioni ka për qëllim të sigurojë që protokollet e krizës të përcaktojnë qartë të gjitha këto:	1	48.4	4. Koordinator i Shërbimeve Digjitale siguron që protokollet e krizës të përcaktojnë qartë të gjitha sa vijon:	F	
48.4.a	a)parametrat specifikë për të përcaktuar se çfarë përbën rrethanat specifike të jashtëzakonshme që protokollin i krizës kërkon të trajtojë dhe objektivat që ndjek;	1	48.4.a	a) parametrat specifikë për përcaktimin e rrethanës së jashtëzakonshme që protokollin trajton dhe objektivat që ai ndjek;	F	
48.4.b	b)rolin e çdo pjesëmarrësi dhe masat që ata duhet të vendosin në përgatitje dhe sapo të jetë aktivizuar protokollin i krizës;	1	48.4.b	b)rolin e secilit pjesëmarrës dhe masat që ata duhet të zbatojnë gjatë përgatitjes dhe pas aktivizimit të protokollit të krizës	F	
48.4.c	c)një procedurë e qartë për përcaktimin se kur do të aktivizohet protokollin i krizës;	1	48.4.c	c)një procedurë të qartë për përcaktimin e momentit kur protokollin i krizës aktivizohet;	F	
48.4.d	d)një procedurë e qartë për përcaktimin e periudhës gjatë së cilës do të merren masat që do të merren sapo të jetë aktivizuar protokollin i krizës, e cila kufizohet rreptësisht në atë që është e nevojshme për trajtimin e rrethanave specifike të jashtëzakonshme të interesuara;	1	48.4.d	d)një procedurë të qartë për përcaktimin e periudhës gjatë së cilës zbatohen masat pas aktivizimit të protokollit të krizës, e cila kufizohet rreptësisht në atë që është e nevojshme për trajtimin e rrethanave të jashtëzakonshme përkatëse;	F	
48.4.e	e)masat mbrojtëse për të trajtuar çdo efekt negativ në ushtrimin e të drejtave themelore të parashikuara në Kartë, në veçanti lirinë e shprehjes dhe të informacionit dhe të drejtën e mosdiskriminimit;	1	48.4.e	e)garanci për adresimin e çdo ndikimi negativ në ushtrimin e të drejtave themelore të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe informacionit dhe të drejtën për mosdiskriminim;	F	
48.4.f	f)një proces për të raportuar publikisht mbi çdo masë të marrë, kohëzgjatjen e tyre dhe	1	48.4.f	f)një proces për raportimin publik të masave të marra, kohëzgjatjes dhe rezultateve të tyre, pas përfundimit të situatës së krizës.	F	

	rezultatet e tyre, pas përfundimit të situatës së krizës.					
48.5	Nëse Komisioni konsideron se një protokoll krize nuk arrin të trajtojë në mënyrë efektive situatën e krizës, ose të mbrojë ushtrimin e të drejtave themelore siç përmendet në paragrafin 4, pika e), ai do t'u kërkojë pjesëmarrësve të rishikojnë protokollin e krizës, duke përfshirë marrjen e masave shtesë.	1	48.5	5. Nëse Koordinator i Shërbimeve Digjitale vlerëson se një protokoll krize nuk arrin të trajtojë në mënyrë efektive situatën e krizës, ose nuk garanton ushtrimin e të drejtave themelore të përmendura në shkronjen "e", të paragrafit 4, të këtij neni, ai kërkon nga pjesëmarrësit rishikimin e protokollit të krizës, përfshirë marrjen e masave shtesë.	F	
49.1	Neni 49 Autoritetet kompetente dhe koordinatorët e shërbimeve digjitale 1. Shtetet anëtare caktojnë një ose më shumë autoritete kompetente për të qenë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje ('autoritetet kompetente').	1	49.1	Neni 49 Autoritetet kompetente dhe Koordinator i Shërbimeve Digjitale 1. Autoritetet kompetente shqiptare, për qëllimet e këtij ligji përgjegjëse për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse dhe zbatimin e këtij ligji, janë: a) Autoriteti i Medias Audiovizive, organi rregullator për sektorin e medias; b) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, organi rregullator për sektorin e komunikimeve elektronike; c) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për mbrojtjen e të dhënave personale; ç) Autoriteti i Konkurrencës; d) Agjencia për mbrojtjen e konsumatorit; - dh) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike; 1.1 Përveç autoriteteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, institucionet e mëposhtme janë organe administrative kompetente për lëshimin e urdhrave sipas parashikimeve në nenet 9 dhe, 10 të këtij ligji: a) Ministria përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore kundër terrorizmit dhe nxitjes së terrorizmit;	F	

	50, 51 dhe 56, zbatohen gjithashtu për çdo autoritet tjetër kompetent që Shtetet Anëtare caktojnë sipas paragrafit 1 të këtij neni.			përcaktuara në nenet 50, 51 dhe 56, të këtij ligji, zbatohen gjithashtu për çdo autoritet tjetër kompetent të përcaktuar sipas paragrafit 1, të këtij neni.		
50.1	Neni 50 Kërkesat për Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale Shtetet anëtare sigurojnë që Koordinatorët e tyre të Shërbimeve Dixhitale të kryejnë detyrat e tyre sipas kësaj Rregulloreje në mënyrë të paanshme, transparente dhe në kohën e duhur. Shtetet anëtare sigurojnë që Koordinatorët e tyre të Shërbimeve Dixhitale të kenë të gjitha burimet e nevojshme për të kryer detyrat e tyre, duke përfshirë burime të mjaftueshme teknike, financiare dhe njerëzore për të mbikëqyrur në mënyrë të përshtatshme të gjithë ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që janë në kompetencën e tyre. Çdo Shtet Anëtar siguron që Koordinatori i tij i Shërbimeve Dixhitale të ketë autonomi të mjaftueshme në menaxhimin e buxhetit të tij brenda kufijve të përgjithshëm të buxhetit, me qëllim që të mos ndikojë negativisht në pavarësinë e Koordinatorit të Shërbimeve Dixhitale.	1	50.1	Neni 50 Kërkesat për Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale 1. Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale i kryejnë detyrat e tyre sipas këtij ligji në mënyrë të paanshme, transparente dhe brenda afateve. Ata disponojnë të gjitha burimet e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, përfshirë burime të mjaftueshme teknike, financiare dhe njerëzore për mbikëqyrjen efektive të të gjithë ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse që janë në fushën e kompetencës së tyre. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka autonomi të mjaftueshme në menaxhimin e buxhetit të tij brenda kufijve të përgjithshëm të buxhetit, në mënyrë që të mos cenohet pavarësia e tij.	F	
50.2	Kur kryejnë detyrat e tyre dhe ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me këtë Rregullore, Koordinatorët e Shërbimeve Dixhitale veprojnë me pavarësi të plotë. Ata do të mbeten të lirë nga çdo ndikim i jashtëm, qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, dhe as nuk do të kërkojnë dhe nuk do të marrin udhëzime nga ndonjë autoritet tjetër publik apo ndonjë palë private.	1	50.2	2. Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre në përputhje me këtë ligj, Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale veprojnë në pavarësi të plotë. Ata nuk i nënshtrohen asnjë ndikimi të jashtëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe nuk kërkojnë apo pranojnë udhëzime nga asnjë autoritet tjetër publik apo subjekt privat.	F	
50.3	Paragrafi 2 i këtij neni është pa paragjykim për detyrat e Koordinatorëve të Shërbimeve Dixhitale brenda sistemit të mbikëqyrjes dhe zbatimit të parashikuar në këtë rregullore dhe bashkëpunimin me autoritetet e tjera kompetente në përputhje me nenin 49, paragraf 2. Paragrafi 2 i këtij neni nuk do të pengojë ushtrimin e shqyrtimit gjyqësor dhe do të jetë gjithashtu pa paragjykim për të proporcionuar kërkesat e përgjegjshmërisë në lidhje me aktivitetet e përgjithshme të Koordinatorëve të Shërbimeve Dixhitale, të tilla si shpenzimet financiare apo raportimi në parlamentet kombëtare, me kusht që këto	1	50.3	3. Paragrafi 2, i këtij neni, nuk cenon detyrat e Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale brenda sistemit të mbikëqyrjes dhe zbatimit të parashikuar në këtë ligj, si dhe bashkëpunimin me autoritetet e tjera kompetente. Paragrafi 2, i këtij neni, nuk pengon ushtrimin e kontrollit gjyqësor dhe as nuk cënon kërkesat proporcionale të llogaridhënies lidhur me aktivitetet e përgjithshme të Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale, si shpenzimet financiare ose raportimi ndaj parlamenteve kombëtare, me kusht që	F	

	kërkesa të mos dëmtojnë arritjen e objektivave të kësaj rregulloreje.			këto kërkesa të mos cenojnë arritjen e objektivave të këtij ligji.		
51.1	Neni 51 Kompetencat e Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale Kur është e nevojshme për të kryer detyrat e tyre sipas kësaj rregulloreje, Koordinatorët e Shërbimeve Dixhitale kanë kompetencat e mëposhtme të hetimit, në lidhje me sjelljen nga ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që bien në kompetencën e Shtetit të tyre Anëtar:	1	51.1	Neni 51 Kompetencat e Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale 1. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka kompetencat e mëposhtme hetimore, në lidhje me sjelljet e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse që përfshihen në kompetencën e tij:	F	
51.1.a	a) fuqinë për t'u kërkuar atyre ofruesve, si dhe çdo personi tjetër që vepron për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tyre që mund të jenë në dijeni të arsyeshme të informacionit lidhur me një shkelje të dyshuar të kësaj rregulloreje, duke përfshirë organizatat që kryejnë kontrollet e përmendura në nenin 37 dhe nenin 75, paragraf 2, për të dhënë informacion të tillë pa vonesa të tepërta;	1	51.1.a	a) kompetencën për t'u kërkuar këtyre ofruesve, si dhe çdo personi tjetër që vepron për qëllime të lidhura me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij dhe që mund të ketë informacion lidhur me një shkelje të dyshuar të këtij ligji, përfshirë organizatat që kryejnë auditimet e përmendura në nenin 37 dhe paragrafi 2 i nenit 75, të këtij ligji, të japin informacionin përkatës në mënyrë të menjëhershme;	F	
51.1.b	b) fuqinë për të kryer, ose për të kërkuar një autoritet gjyqësor në shtetin e tyre anëtar për të urdhëruar, inspektime të çdo ambienti që ata ofrues ose ata persona përdorin për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tyre, ose për t'u kërkuar autoriteteve të tjera publike ta bëjnë këtë, në mënyrë që të shqyrtojnë, kapin, marrin ose marrin kopje të informacionit që ka të bëjë me një shkelje të dyshuar në çfarëdo forme, pavarësisht nga mediumi i magazinimit;	1	51.1.b	b) kompetencën për të kryer, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor që të urdhërojë inspektime në çdo ambient që këta ofrues ose persona përdorin për qëllime të lidhura me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tyre, ose për t'u kërkuar autoriteteve të tjera publike që ta bëjnë këtë, me qëllim shqyrtimin, sekuestrimin, marrjen ose kopjimin e informacionit në çdo formë që lidhet me një shkelje të dyshuar, pavarësisht nga mjete i ruajtjes;	F	
51.1.c	c) Fuqinë për t'i kërkuar çdo anëtar të stafit apo përfaqësuesit të këtyre ofruesve apo atyre personave të japin shpjegime në lidhje me çdo informacion që ka të bëjë me një shkelje të dyshuar dhe të regjistrojë përgjigjet me pëlqimin e tyre me çdo mjet teknik.	1	51.1.c	c) kompetencën për t'i kërkuar çdo anëtar të personelit ose përfaqësuesi të këtyre ofruesve, ose personave, që të japë shpjegime për çdo informacion që lidhet me një shkelje të dyshuar dhe për të regjistruar përgjigjet e tyre me pëlqimin e tyre, përmes çdo mjeti teknik.	F	
51.2	Kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje, Koordinatorët e Shërbimeve Dixhitale kanë kompetencat e mëposhtme të zbatimit, në lidhje me ofruesit e	1	51.2	2. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka kompetencat e mëposhtme zbatuese, në lidhje me ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që përfshihen në kompetencën e tij:	F	

	shërbimeve ndërmjetëse që bien në kompetencën e Shtetit të tyre Anëtar:					
51.2.a	a) fuqinë për të pranuar angazhimet e ofruara nga këta ofrues në lidhje me respektimin e tyre me këtë Rregullore dhe për t'i bërë këto angazhime detyruese;	1	51.2.a	a) kompetencën për të pranuar angazhimet e ofruara nga këta ofrues në lidhje me përputhshmërinë me këtë ligj dhe për t'i bërë këto angazhime të detyrueshme;	F	
51.2.b	b) fuqinë për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljeve dhe, kur është e përshtatshme, për të vendosur rekurse në proporcion me shkeljen dhe të nevojshme për t'i dhënë fund shkeljes në mënyrë efektive, ose për të kërkuar një autoritet gjyqësor në shtetin e tyre anëtar për ta bërë këtë;	1	51.2.b	b) kompetencën për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljeve dhe kur është e përshtatshme, për të vendosur masa proporcionale me shkeljen dhe të nevojshme për ta përfunduar atë në mënyrë efektive, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor që ta bëjë këtë;	F	
51.2.c	c) fuqinë për të vendosur gjoba, ose për të kërkuar një autoritet gjyqësor në shtetin e tyre anëtar për ta bërë këtë, në përputhje me nenin 52 për moszbatim të kësaj rregulloreje, duke përfshirë ndonjë nga urdhrat hetimorë të lëshuar sipas paragrafit 1 të këtij neni;	1	51.2.c	c) kompetencën për të vendosur gjoba, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor që ta bëjë këtë, në përputhje me nenin 52, të këtij ligji, për mosrespektim të këtij ligji, përfshirë moszbatimin e urdhrave hetimorë të lëshuara sipas paragrafit 1, të këtij neni;	F	
51.2.d	d) fuqinë për të vendosur një pagesë periodike dënimi, ose për të kërkuar një autoritet gjyqësor në shtetin e tyre anëtar për ta bërë këtë, në përputhje me nenin 52 për të siguruar që një shkelje të përfundojë në përputhje me një urdhër të lëshuar sipas pikës b) të këtij nënparagrafi ose për mosrespektim të ndonjë prej urdhrave hetimorë të lëshuar sipas paragrafit 1 të këtij neni;	1	51.2.ç	ç) kompetencën për të vendosur pagesa periodike penalizuese, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor që ta bëjë këtë, në përputhje me nenin 52, të këtij ligji, për të siguruar ndërprerjen e shkeljes në përputhje me një urdhër të lëshuar sipas shkronjës “b” të këtij paragrafi, ose për moszbatim të urdhrave hetimorë sipas paragrafit 1, të këtij neni;	F	
51(2)e	e) fuqinë për të miratuar masa të përkohshme ose për t'i kërkuar autoritetit kompetent gjyqësor kombëtar në shtetin e tyre anëtar ta bëjë këtë, për të shmangur rrezikun e dëmtimit të rëndë.	1	51.2.d	d) kompetencën për të miratuar masa të përkohshme, ose për të kërkuar nga autoriteti gjyqësor kompetent që ta bëjë këtë, me qëllim shmangien e rrezikut të një dëmi serioz.	F	
51.2, pg. 2	Sa i përket nënparagrafit të parë, pikat (c) dhe d), Koordinatorët e Shërbimeve Dixhitale kanë gjithashtu kompetencat e zbatimit të përcaktuara në këto pika në lidhje me personat e tjerë të përmendur në paragrafin 1 për mosrespektim të ndonjë prej urdhrave që u janë lëshuar sipas këtij paragrafi. Ata do t'i ushtrojnë këto fuqi zbatuese vetëm pasi t'u japin atyre personave të tjerë në kohë të mirë të gjitha informacionet e duhura lidhur me këto urdhra, duke përfshirë periudhën e zbatueshme, gjokat ose pagesat periodike që mund të vendosen për mosrespektim dhe mundësitë për ndreqje.	1	51.3	3. Në lidhje me pikën (c) dhe (d) të nënparagrafit të parë, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ushtron këto kompetenca zbatuese edhe ndaj personave të tjerë të përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, për moszbatimin e urdhrave të lëshuara ndaj tyre sipas këtij paragrafi. Këto kompetenca ushtrohen vetëm pasi t'u jetë dhënë këtyre personave, në kohë të përshtatshme, i gjithë informacioni përkatës lidhur me urdhrat, përfshirë afatin e zbatimit, gjokat ose pagesat	F	

				periodike që mund të vendosen dhe mjetet juridike të disponueshme.		
51.3	Kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje, Koordinatorët e Shërbimeve Dixhitale, në lidhje me ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që bien në kompetencën e Shtetit të tyre Anëtar, ku të gjitha kompetencat e tjera në bazë të këtij neni për të sjellë ndërprerjen e një shkeljeje janë shteruar dhe shkelja nuk është ndrequr ose po vazhdon dhe po shkakton një dëm serioz i cili nuk mund të shmanget nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të tjera në dispozicion Sipas ligjit të Bashkimit ose Kombëtar, kanë gjithashtu fuqinë të marrin masat e mëposhtme:	1	51.4	4. Kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave sipas këtij ligji, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në lidhje me ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që përfshihen në kompetencën e tij dhe kur të gjitha kompetencat e tjera sipas këtij neni për ndërprerjen e shkeljes janë shteruar, ndërsa shkelja nuk është korrigjuar ose vijon dhe shkakton dëm serioz që nuk mund të shmanget përmes ushtrimit të kompetencave të tjera të disponueshme sipas legjislacionit kombëtar, ka gjithashtu kompetencat e mëposhtme:	F	
51.3.a	a)t'i kërkojë organit drejtues të këtyre ofruesve, pa vonesa të tepërta, të shqyrtojë situatën, të miratojë dhe të paraqesë një plan veprimi që përcakton masat e nevojshme për ndërprerjen e shkeljes, të sigurojë që ofruesi t'i marrë këto masa dhe të raportojë mbi masat e marra;	1	51.4.a	a) t'i kërkojë organit drejtues të këtyre ofruesve, të shqyrtojë situatën pa vonesë, të miratojë dhe paraqesë një plan veprimi që përcakton masat e nevojshme për ndërprerjen e shkeljes, të sigurojë që ofruesi i zbaton këto masa dhe të raportojë mbi masat e marra;	F	
51.3.b	b)kur Koordinator i Shërbimeve Dixhitale konsideron se një ofrues i shërbimeve ndërmjetëse nuk ka respektuar mjaftueshëm kërkesat e përmendura në germën a), se shkelja nuk është ndrequr ose nuk po vazhdon dhe po shkakton dëme të rënda dhe se kjo shkelje sjell një vepër penale që përfshin një kërcënim për jetën ose sigurinë e personave, të kërkojë që autoriteti gjyqësor kompetent i shtetit të tij anëtar të urdhërojë kufizimin e përkohshëm të aksesit të marrësve në shërbimin në fjalë nga shkelja ose, vetëm kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme, në ndërfaqen online të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse mbi të cilat bëhet shkelja.	1	51.4.b	b) kur Koordinator i Shërbimeve Digjitale vlerëson se ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse nuk ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e shkronjës “a”, se shkelja nuk është korrigjuar ose vijon dhe shkakton dëm serioz dhe se kjo shkelje përbën vepër penale që përfshin kërcënim për jetën ose sigurinë e personave, të kërkojë nga autoriteti gjyqësor kompetent të urdhërojë kufizimin e përkohshëm të aksesit të marrësve në shërbimin përkatës ose, vetëm kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme, të urdhërojë kufizimin në ndërfaqen online të ofruesit ku ndodh shkelja.	F	
	Koordinatori i Shërbimeve Dixhitale, përveç kur vepron sipas kërkesës së Komisionit të përmendur në nenin 82, përpara paraqitjes së kërkesës së përmendur në nënparagrafin e parë, pika (b), të këtij paragrafi, fton palët e interesuara të paraqesin vëzhgime me shkrim brenda një periudhe që nuk do të jetë më pak se dy javë, duke përshkruar masat që ka ndërmend	1	51.5	5. Përpara paraqitjes së kërkesës sipas germës b), të pikës 3, të këtij neni, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, fton palët e interesuara të paraqesin vërejtje me shkrim, brenda një afati jo më të vogël se dy javë, duke përshkruar masat që kërkon	F	

